




Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, Viti i XII i botimit, nr. 148, shkurt 2016

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355692465784, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktor: Luigj Shyti, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

MOS E SHIT TOKËN E BABËS, O VËLLA!



TI QOFSH LËVDUAR

Me datën 18 shkurt 2016, në mjediset e Seminarit Ndërdioqezan, e organizuar nga Ipeshkivia Metropolitane Shkodër-Pult, u bë paraqitja e Enciklikës së Papa Françeskut, e titulluar “Ti qofsh Lëvduar” (Laudato si’). Në këtë paraqitje morën pjesë intelektual, shkrimtar e poet, veprimtar të fushave të ndryshme. Ceremoninë e drejtoi Profesor-doktor, shkrimtari e poeti, pedagogu në Universitetin “Luigj Gurakuqi”, Alfred Çapaliku. Të pranishmit i përshëndeti Imzot Angelo Massafro-OFM. Kumtuan Dr. Albert Nikolla. Motër Rita Ndoci dhe Atë Mario Imperatori Sj.

3

Në përfundim të veprimtarive, në 25 vjetorin e Meshës së parë

Me 31 Janar 2016 u mbyllën në mënyrën më të mire të mundshme, në një veprimtari të veçantë për nga lloji i vet, veprimtaritë që u zhvilluan në kuadër të 25 vjetorit të meshës së parë mbajtur me 04 nëntor 1990 nga dom Simon Jubani. Kjo veprimtari shumë anshme, u zhvillua në oborrin e rikonstruktuar të katedrales së Shën Shtjefnit e ndërtuar, në vitin 1865, e cila mori emrin “Kisha e Madhe”, nëna e të gjitha kishave.

Kjo veprimtari u drejtua nga moderatorja e talentuar, Marinela Buxha, e cila me shume profesionalizëm e drejtoi këtë veprimtari, e cila në qendër të saj kishte memorialin e lirisë, shtatoren e martirizimit, që skulptori i talentuar Agim Rada ia dhuroi qytetit të Shkodrës martire, në respekt të bijve të saj më të mire, e cila është një vlerë e shtuar për këtë katedrale, këtë qytet dhe ata që do t’i vizitojnë. “Kjo skulpturë, e para antikomuniste, është akt i lirisë dhe i martirizimit të popullit shqiptar ...

4

FREDERIK RESHPJA, TURPI I SHQIPERISË ZYRTARE

6

- MEMORSITIKË ME RASTIN E 10 VJETORIT TË VDEKJES -

Me 17 shkurt të vitit 2006 pushoi së rrahuri tikt-taku i zemrës së poetit dhe lirikut të dliër, Frederik Rreshpja. U bene plot 10 vite shpirti i poetit gjeti prehjen në një botë më të mirë e më humane, se ajo që kaloi në atë injorancë dhe indiferencë cinike që e la të vdesë në një vafëri dhe mjerim të tmerrshëm. 10 vite më pare u nda prej ai, që Hans-Joachim Lanksch e ka quajtur poetin, që qante edhe për zogjtë dhe që u shpjegoi atyne që “edhe unë jam pa fole”. Shqipëria zyrtare nuk dha poetit të madh të saj një fole!! Pena qau mjeshttrin, lirika shqiptare humbi shëlbuesin, miqtë dhe adhuresit u trishtuan për ikjen e Fredit, ndërsa shpirti i tij fluturoi si pëllumb, i shkoi drejt parajsës, sepse për një njerëzi aq shpirtmirë sa ai, Zoti ka krijuar parajsë botes së andejme (jetës së pa sosur).

Shqiptarët e Mesjetës drejtonin botën

Dr. Aleksandre Lambert, historian, drejtor akademik i “School of International Training” në Gjenevë, është autor i disa librave dhe artikujve në fushën e relacioneve ndërkombëtare të filozofisë politike, të politikës së sigurisë dhe lidhjeve civile-ushtarake. Lambert ka vizituar Shqipërinë dhe ka filluar të njohë çështjen shqiptare që në rini të tij me kërkimet e bëra në Arkivin e Lidhjes së Kombeve Gjenevë, kur njohu mirë edhe çështjen çame. Historiani zviceran Dr. Aleksandre Lambert këmbëngul se nuk është e rastit që shqiptarët në asnjë moment të historisë nuk njihen si komb që ka sulmuar kombet e tjerë dhe se shumë shqiptarë kanë shkëlqyer duke drejtuar qoftë perandori, qoftë shtete të tjera.

9

BURRËRIA, BUJARIA, NDERI DHE MORALI, KANE QENE TË LARTA E TË PAPËRLYER PËR DUKAGJINASIN

Si shkrimtar jam i kënaqur, se i kam shërbyer atdheut dhe Shkodrës, me shkrimet e mija të çdo gjinie letrare. Librat dhe dramat e mija kryesisht trajtojnë temat e Veriut e sidomos të Dukagjinit, sepse kjo zone më ka frymëzuar gjithmonë për burrërinë, patriotizmin, nderin dhe besën.

5

LAHUTA

Lahuta është një nder instrumentet më të vjetër në Shqipërinë e veriut, që vjen mbas lëpushtres, pipzës, zymares dhe borisë, instrumente këto të ndërtuara me mjete rrethimore natyrore. Lahuta ishte i vetmi instrumente që u lëvru nga rapsodia e jone e vjetër, mbas këngës majekrahrahu (ekapelle). Ky instrument i vjetër është moshatare me brezat që kane populluar zonat e krahinat tona. Lahuta më e vjetër, që jam dëshmitar okular, është gjendur në fshatin Gjuraj-Pult- që kishte më tepër se dyqind e njëzetë e gjashtë vite dhe me interesantja ishte që kupa e saj kishte formën e zemrës së njeriut, që tregon si të vetmin instrument, me të cilën njerëzit kane mundur...

MOS E SHIT TOKËN E BABËS, O VËLLA!

Thethi kjo hyri natyrore e mrekullueshme për xhelozuar edhe alpet Evropës. Një virgjëri ekzotike e pa përkujdesur nga dora e njeriut, një manushaqe kundërmuese e izoluar nga ferri infrastruktural i shtetit leckaman 100 vjeçar. Thethi kjo vashe e dli­rë e pa shoqe me fytyrë hënore, kjo vashe e varfër jetime pa prindërim shtetërore, kjo vashe te ndrujtur, qe sa po ka filluar te zbulojë huret e veta dhe nuk din te administroje afshin e vet qe i valon ne gji. Thethi se shpejti mund te këtë “mrekullinë e tete”. (rrugen e asfaltuar,). Por ai ndihet me i rrezikuar se kurrë nga epidemia e ndotjes qe do depërtoje se bashku me rritjen e vizitorëve,sidomos ata shqiptare. Thethi sot ndihet i rrezikuar nga ndërtimet pa leje, eterniti dhe llamarina qe po sfidojnë dër­rasën e pishës. Thethi sot dhe akoma me tepër nesër ndihet me i rrezikuar se kurrë, nga lakmia uria, egërsia dhe dinakëria e grabiqarve te rafinuar te parasë dhe pushtetit. Krokodilët kanë depërtuar nga portat e Shalës dhe janë strukur diku brigjeve kanjonit afër ujëvarave, krojeve e buneve. Ata qajnë me lot “mallëngjim” e rrine ne pritje për shqyer gjithçka te mundin. Bajlozat duan trojet, lëndinat, burimet ograjt, pyjet, kullotat te cilat ndonëse Thethi i keto pasuri ka hise babe te gjitha janë te pa hipotekuara. Shkoni skandalin e fundit ku 8000 metër kater-orve na paskane qene hipotekuar ne me mënyre te paligjshme duke ja kaluar dikujt qe nuk ka lidhje fare me kete zone. Theth-janet shquhen për sensin praktik intuitën dhe prirjen nga e reja, por ndihen te rrezikuar nga pazaret e pista te maskuara me vel­lon e ekonomisë e tregut. Thethi rasti juaj eshte specifik,eshte një pasuri jo vetëm e juaja por një pasuri dhe vlere kombëtare. Jeni park kombëtare turistik dhe ju nuk mund te ndërtoni si te doni. Nuk mund te shfrytëzoni resurset si te doni sot për nesër. Ju nuk mund te shërbeni as turistëve si ne restorantet dhe baret e Shkodrës Shirokës, Velipojës e qyteteve, pasi do ishte vetëvrasje. Ju duhet te zini mend nga banoret e Gjiri te Lalzit, bregdeti i rivierës, Currilat , Golemi, Velipoja, Dajti, Llogaraja etj te cilat janë kthyer në Qerbela te fitimi te piste duke përmbysur gjithë strukturën sociale te mëparshme. Ju thethjanë nuk duhet te rreheni si krapu me karem dhe tua shisni Thethin tjerëve te cilet do ta tjetersojne per qellime fitimi ! Nuk e them këtë për as një lloi fobie, as diversioni social. Thethi duhet te behet perle joshëse me infrastrukturën qe meriton qe sot nuk e ka . Thethi ka banoret e vet autokton, dhe traditën te ripërtërirë por nuk mund behet nje paçovure katike ndertimesh dhe pushtuesish te fuqishem qe nuk i lidhe as gje me bjeshke përveç parase .(Thethi nuk mund te kete infrasruktur te plote po nuk u lidhi i gjithë krahina e Dukagjini me infrasrukture te asfaltaur dhe te gjitha resurset e kësaj zone te vihen ne sherbim te turizmit Ju thethjanë nuk duhet te flirtoni msheftas me vipat trafiqueve dhe te politikës në dem te tjetërsimit te pasurive tuaja. Këta turikrokodil kanë aq para dhe asete sa ta blejnë komplet Thet-hin se bashku kullat arat dhe kordonin e maleve për rreth! Thethjan mos e shitni thethin per biskota se nuk do blini me as me flori!

PRELE MILANI
poet studiues dhe publicist

Thethi është një perlë e paçmuar. Prej kohësh këtë fshat e kanë ruajtur në mënyrën më të mirë të mund­shme banorët e tij. Dhe jo pak por mbi 300 vjet. Është treguar kujdes që popullsia e këtij fshatit të mos përzihet, të mos laraviet, të mos ndryshohet. Duke përballuar kushtet ekonomike shoqërore dhe natyrore, duke përballuar vështirësitë ekonomike, kalimin e përsëritur të pushtuesëve të huaj, arritën që të ruajnë dhe tua sjellin brezave që ta kenë, dhe këta duhet tua dorëzojnë brezave të ardhshëm. Në qoftë se nuk kemi çfarë tu lëmë, brezat që do të vinë, do të na gjykojnë me ashpërsi, do të na kritikojnë, pse jo do të na shajnë, do të na mallkojnë.

Për shekuj nuk është shitur toka e fshatit Theth, sepse po të ishte vepruar kështu sot nuk do të kishim se për çfarë të flisnim tash. Fshati Theth është plotësisht i pastër nga banorë jashtë lidhjes së gjakut. Secila pronë është trashëguar drejtpërdrejt të pasardhësit. Po, është shitur dhe blerë tokë në Theth, është ndërruar dhe krahishtuar, por, gjithmonë brenda përbrenda degëve të pemës familjare, apo brenda degëzime të tjera sipas afërsisë. Kjo ka bërë që të mos ndodhë përzierja.

Po sot çfarë po ndodhë me tokën e fshatit Theth. Siç po flitet, janë shtrirë thonjtë e atyre që kanë para dhe po i drejtohen kësaj perle, e me sa duket, për ta coptuar, për ta ndarë, për ta përvetësuar, duke tundur parat. Vërtetë malësorët e këtyre anëve kanë trashëguar varfëri, sepse kohët ishin të tilla. Ata dëshirojnë më shumë përparim e kulturë, pasuri dhe rehati. Duke i ditur këto, parelinjë, shfrytëzojnë rastin dhe fillojnë pazaret, dhe nevojat i joshin për ta shitur tokën, atë tokë për të cilën u rropatën breza të tërë për ta ruajtur, dhanë edhe jetën shumë për ta mbrojtur.

Po a mund të shitet toka jote, e babës, e gjyshit apo stërgjyshit, për një grusht letra që quhen lekë. Me ato lekë nuk bëhet asgjë në krahasim me vlerën që ka kjo tokë. Pak ditë më vonë nuk ke parat por as tokën. Djali jot, i dashur vëlla, kur të rritet, do të thonë se përse unë nuk kam tokë si të tjerët në lagjen timë, në fshatin tim, pse jam pa tokë. Dhe mallkimet nuk do të reshtin.

Janë bërë regjistrime, reregjistrime, harta por nuk ka gjetur zgjidhje. Shteti dhe organet e qeverisjes ven-dore duhet të merren seriozisht me këtë punë. Ka 25 vjet që këta banorë nuk kanë marrë certifikatat e pro-nave të tyre të trashëguara ndër breza. Pse ndodhe kështu? Gjithçka mund te jenë por në interes të këtyre banorëve dhe të këtij fshati nuk është dhe nuk ka se si te jenë. Deri kur do ta vazhdojë kjo padrejtësi? Hipo-tekimi i tokve dhe shtëpive ne Theth krijon mundësinë e zhvillimit të fshatit sepse mund të përdoren si kolat-eral (dorëzani) në mardhëniet me bankat, mund të merren kredi dhe mund të nxitet zhvillimi. Dokumentimi dhe hipotekimi i pronave në Theth duhet kërkuar me vendosmëri në të gjitha instancat e shtetit shqiptar.

Çuditë shumë se si ata që kërkojnë të futin duart në tokën e Thethit, nuk janë të interesuar për doku-mentet. A mund të shitet dhe blihet toka, prona, pa dokumente zyrtare? Behen gabime, por, për hirë të një gabimi nuk duhet të lejohën të bëhen gabime të tjera. Së pari këtë detyrë duhet ta kryejnë vetë banorët. Ata duhet ta duan dhe ta mbrojnë, ta shfrytëzojnë për vetë dhe të mendojnë për fëmijët, nipërit e stërnipërit e tyre. Kështu kanë vepruar edhe të parët tonë, prandaj e kemi ne këtë tokë dhe këta shtëpi.

Para pak më shumë se një dekadë, edhe kam thirrur me sa fuqi që kisha “SOS, Thethi po shkretohet”. Dhe ashtu ishte, kishin mbetur vetëm 12-13 familje që banonin në mënyrë të përhershme në Theth. Por tash, Thethi ka filluar të ripërtihet. Në të gjithë lagjet e fshatit ka ndërtime të reja, madje shumë të bu-kura, mbështetur në traditën e zonë, natyrisht me përmirësime brenda saj. Ka edhe ndonjë që duhet të përmirësohet. Gjithsesi rizgjimi po vjen, madje mjaftë shpejt. Në këtë drejtim, banorët, duhet të gjejnë mbështetje te shteti me të gjitha mënyrat për të vënë në punë vlerat e pronës së tyre. Nuk ka sesi të “falët” toka, prona për një grusht para që shpejt do të pendohesh por atëherë ka me këne vonë, shumë vonë. Konkurrenca nuk të fal. I fuqishmi jeton, madje gllabëron ata më të vegjëlit. Këtë duhet pasur mirë parasyshë. Globalizimi do të vijë edhe në Theth, por duhet të na gjejë të qëndrueshëm, të mos na gllabërojnë lehtë, të kemi historinë dhe kulturën tonë të mirë, të kemi pronën tonë mbëkëmbur.

Prandaj, vllazën, të mos e shesim dhe as të mos e falim tokën e të parëve, atë tokë që është larë me gjak e djersë nga të parët tonë, atë tokë që mban eshtrat e të parëve tonë. Brezat e ardhshëm do të na gjykojnë ashpër po ta bëjmë këtë veprim sot. Po, mund dhe do të vinë koha që mund të shitet e blihet, por sot nuk është koha, sepse sot falet sido që duket se po e shet.

Të mos na kënaqë trigëdhima e disa monedhave, apo feshfërimë e disa kartëmonedhave, të mos na kënaq, edhe ndonjë karriqe sepse është thjeshtë kalimtare, e përkohshme. Toka, prona nuk kalbet thot populli. Ato qëndrojnë aty gjithmonë, mjafton të mos i shesësh, të mos i falësh, të mos i tjetërsosh, të mos i shpërdorosh.

Luigj SHYTI



TI QOFSH LËVDUAR

Me datën 18 shkurt 2016, në mjediset e Seminarit Ndërdioqezan, e organizuar nga Ipeshkivia Metropolitane Shkodër-Pult, u bë paraqitja e Enciklikës së Papa Françeskut, e titulluar “Ti qofsh Lëvduar” (Laudato si’).

Në këtë paraqitje morën pjesë intelektual, shkrimtar e poet, veprimtar të fushave të ndryshme.

Ceremoninë e drejtoi Profesor-doktor, shkrimtari e poeti, pedagogu në Universitetin “Luigj Gurakuqi”, Alfred Çapaliku.

Të pranishmit i përshëndeti Imzot Angelo Massafro-OFM. Kumtuan Dr. Albert Nikolla. Motër Rita Ndoci dhe Atë Mario Imperatori Sj.

Pas kumtimeve, nga të pranishmit pati pyetje dhe diskutime.


Libri “Ti qofsh Lëvduar” është në nderin e të gjithëve jo vetëm ta kenë në bibliotekën e tyre, jo vetëm ta lexojnë atë, por kryesisht të marrin përgjegjësinë për të kontribuar në vënien në jete të gjitha atyre porosive, që janë detyra për të njihe, që na bën thirrje Ati i Shenjtë, Papa Françesku.

PËRSHËNDETJE E IMZOT ANGELO MASSAFRA-OFM, NË PREZANTIMIN E ENCIKLIKËS “TI QOFSH LËVDUAR” (LAUDATO SI)



Mirë se keni ardhur. Ju përshëndes të gjithëve.

Përshëndes Imzot Lucjan Avgustinin, Falënderoj Dom Leonardin, Rektorin



për pranimin në seminar.

Falënderoj Moderatorin: Prof. Dr. Çapalikun; Relatorët: Atë Mario Imperatori, z. Albert Nikolla, Motër Rita Ndoci, ata që kanë bashkëpunuar me mua në përkthimin dhe stampimin e Enciklikës...

Falënderoj juve të pranishëm.

Ti qofsh Lëvduar: është kënga i Shën Françeskut i Azisit..quhet edhe Kënga e Vëllait Diell, e cila e kthen gjithë botën e krijuar te Krijuesi, ia kthen Hyjit qendërsinë e tij.

Dhe nëse kjo vlente në kohët e Varfajakut të Asizit, aq më tepër vlen sot që, prej revolucionit industrial e më tutje, e kemi përjashtuar Hyjin prej horizontit njerëzor, ndoshta pa e mohuar, por sigurisht duke e lënë atë mënjane. Tundimi i hershëm i prindërve të parë riparaqitet periodikisht në histori, ndoshta në forma të ndryshme, por me një forcë gjithnjë e

më të madhe.

Poezia që tregon e këndon Krijuesit buron nga zemra e Gaztori të Hyjit (Il Giullare di Dio).

Mund të përfytyrohet gëzimi im e i Françeskanëve, duke parë se Papa Françesku ka zgjedhur këtë titull për Enciklikën mbi Kujdesin për shtëpinë e përbashkët, Botën e krijuar. Dhe ky gëzim sot përtërihet duke ju paraqitur juve përkthimin e kësaj Enciklike në gjuhën shqipe, me shpresën që ajo të hyjë në të gjitha shtëpitë e katolikëve, para së gjithash, por edhe të të gjithë burrave e grave vullnetmirë.

Toka jonë shqiptare është një përqendrim bukurie natyrore, një dhuratë e Krijuesit ndaj neve, krijesave të tij: kemi terrene pjellore, pyje, male, lumenj, liqene dhe detin, së bashku me panorama që, po t’i sodisim, mbetemi të mahnitur dhe pa frymë, aq e madhe është bukuria e tyre.

Si të mos mendojmë, përballë këtij spektakli të natyrës, për atë që është autori, për Hyjin? Bota e krijuar është si një tabelë shumë e madhe rrugore që na kujton një të vërtetë më të madhe: Krijuesin.

Enciklika e Papa Françeskut, ndërsa na ndihmon të ngjitemi prej krijesave te Krijuesi, na jep edhe nxitje të rëndësishme që të mësojmë ta vlerësojmë botën e krijuar si dhuratë. Deliri i gjithëpushtetësisë i njeriut e bën atë shpesh ta shkatërrojë natyrën ose, të paktën, të mos kujdeset për të. Nëse Hyji e ka vënë njeriun në një shkallë më të lartë në krahasim me krijesat e tjera, kjo nuk do të thotë se duhet t’i mposhtë ato apo t’i keqpërdorë deri në shkatërrimin e tyre. Fakti se jemi më lart, nuk na autorizon të shkatërrojmë: në të vërtetë, kjo na ngarkon me një përgjegjësi, atë që të jemi mbrojtës.

Ati i Shenjtë në Enciklikë nis nga një përshkrim i përpiktë i problematikave kryesore të lidhura me degradimin mjedisor, kujton pastaj themelet biblike të teologjisë së botës së krijuar dhe, para se të japë udhëzimet baritore, përvijon një kuadër të vizionit që njeriu i sotëm ka për vetveten, një vizion me një rrënjë antropologjike të shtrembër që është shkaku i problemit ekologjik kaq të madh në kohën që jemi duke jetuar.

Bashkohem me ndjenjat e Papa Françeskut dhe, megjithëse duke mos gjetur në Atdheun tonë të njëjtat problematika të rënda që jeton bota perëndimore, gjithsesi nuk mund të rri i palëvizur përballë rrezikut të një përvetësimi pasiv të asaj kulture materialiste e konsumiste që shoqërohen në mënyrë të pashmangshme me teknologjinë e progresin dhe që dukshëm janë duke e ndryshuar fytyrën e shoqërisë shqiptare, në të mirë e në të keq.

Por, jemi ende në kohë për ta ndrequr këtë. Nuk duhet thënë se Kisha nuk ka asgjë për të thënë në lidhje me problemet shoqërore: ajo e shikon njerëzimin ashtu sikurse Hyji e ka shikuar dhe e ka dashur, dhe ka detyrën morale t’u tregojë burrave e grave të kohës së vet rrugën kryesore që duhet ndjekur për të arritur të mirën e vërtetë.

Duke jua paraqitur frytin e kësaj pune të gjithëve, ju nxis ta marrim në konsideratë seriozisht, të reflektojmë së bashku me Papën mbi vlerën e jetës dhe të botës së krijuar, të marrim përsipër përgjegjësitë që na takojnë si bashkëpunëtorë të Hyjit në veprën e krijimit dhe të veprojmë konkretisht për të krijuar kushtet më të përshtatshme në mënyrë që Bota e krijuar të vazhdojë ta lëvdojë veprën e Krijuesit në gjithë bukurinë dhe shkëlqimin e vet.

Edhe prej Shqipërisë sonë le të lartësohet himni drejt Qiellit: O Zoti im, ti qofsh lëvduar!

Faleminderit!

Korespodeenti i gazetës “Dukagjini”

VIT TË MBARË O SHKODËR

Të rralla janë organizimet kulturore në Shkodër, por edhe më të rralla janë rastet kur në aktivitete të tilla, sallat tejmushen. Shfaqja artistike “Vit të Mbarë o Shkodër!”, organizuar tradicionalisht që prej dy dekadave nga Arqipeshkvia Shkoder-Pult dhe Komisioni Drejtësi dhe Paqe me rastin e Ditës Botërore të Paqes, ka pasur gjithmonë interesin maksimal të publikut që prej herës së parë që është vënë në skenë. Aktiviteti u parapri nga marshimi “Paqe në Tokë” organizuar nga komuniteti katolik “St. Egidio”

Krahas përcjelljes së një atmosfere të gëzueshme për fillimin e vitit përmes një programi të larmishëm artistik me këngë, valle dhe recitime nga artistët e rinj por të talentuar të Shkodrës, boshti i këtij aktiviteti është edhe përcimi i mesazhit të përvitshëm të Atit të Shenjtë. Duke pasur parasysh numrin e madh të konflikteve të



armatosura në botë, ndjenjën e urrejtjes së verbër për kulturat e ndryshme, frikën dhe ksenofobinë që solli në botë kriza humanitare e refugjatëve nga Lindja e Mesme, Papa Françesku i’u drejtua katolikëve dhe të gjithë njerëzve vullnetmirë të botës, në këtë fillim viti, me mesazhin e tij “Fito mbi Indiferencën dhe Arrije Paqen”.

Është fjala për indiferencën karakteristike të natyrës njerëzore që kur shëndeti, punët dhe ekonomia na shkojnë mbarë, e kemi veshin të shurdhër për

rënkimet e të sëmurëve, për dëshpërimin e të papunëve dhe nxitojmë të gjykojmë ata që varfëria i shtyn në rrugën e vesit dhe krimit. Nëse i gëzojmë të mirat që përmendëm më lart, këtë nuk duhet ta marrim vetëm si meritë personale dhe as të ndjehemi të përkëdhelurit e fatit. Kjo do të thotë se Zoti na ka zgjedhur si instrument të Tijin për të sjellë mirësinë e tij përreth.

Këtë kishte në thelb mesazhi i Atit të Shenjtë i cili u shpërnda për publikun e



Shkodrës në shfaqjen “Vit të Mbarë o Shkodër” moderuar nga çifti i gazetarëve Simon dhe Eliona Shkreli.

Aktiviteti u përshëndet nga Shkëlqesia e tij, Arqipeshkvi Metropolitan i Shkodrës, Imzot Angelo Massafra si dhe nga Kryetarja e re e Bashkisë Shkodër, Znj. Voltana Ademi e cila në fjalën e saj, u shpreh se nismat që i shërbejnë klimës pozitive në komunitet, do të kenë gjithmonë edhe mbështetjen e saj institucionale.

Korrespondenti i “Dukagjinit”

Në përfundim të veprimtarive, në 25 vjetorin e Meshës së parë

Me 31 Janar 2016 u mbyllen në mënyrën më të mire të mundshme, në një veprimtari të veçantë për nga lloji i vet, veprimtaritë që u zhvilluan në kuadër të 25 vjetorit të meshës së pare mbajtur me 04 nëntor 1990 nga dom Simon Jubani. Kjo veprimtari shumë anshme, u zhvillua në oborrin e rikonstruktuar të katedrales së Shën Shtjefnit e ndërtuar, në vitin 1865, e cila mori emrin “Kisha e Madhe”, nëna e të gjitha kishave.

Kjo veprimtari u drejtua nga moderatorja e talentuar, Marinela Buxha, e cila me shume profesionalizëm e drejtoi këtë veprimtari, e cila në qendër të saj kishte memorialin e lirisë, shtatoren e martirizimit, që skulptori i talentuar Agim Rada ia dhuroi qytetit të Shkodrës martire, në respekt të bijve të saj më të mire, e cila është një vlerë e shtuar për këtë katedrale, këtë qytet dhe ata që do t’i vizitojnë. “Kjo skulpturë, e para antikomuniste, është akt i kujtesës dhe i martirizimit të popullit shqiptar e në veçanti i klerit katolik, të cilët përjetuan një kalvar të gjatë mundimesh vetëm për faktin se, e deshën Shqipërinë të lire e me Zot” - u shpreh moderatorja, në fillim të veprimtarisë.

Në këtë veprimtari morën pjesë drejtuesit kryesor të pushtetit vendor, deputete, klerikë e besimtar, si dhe Ministria e Kulturës, Znj. Mirela Kumbaro. Fjalën e rastit e mbajti autori i veprës, skulptori Agim Rada. Ai tha se, në diktaturë, qetësi kishte vetëm në burg, ekzekutoret janë në ferr, kurse të ekzekutuarit janë në parajsë. Memoriali u financua nga biznesmeni shkodran, Gjergj Luca, djali i Artistit të Popullit, Ndreke Luca.

Në emër të pasardhësve, të bashkëvujtësve përshëndeti znj. Meri Ujka, e cila nder të tjera tha: “Faji i vetëm i tyre ishte besimi në Krisht dhe se kishin mendime të ndryshme. Fjalët e tyre të fundit ishin “Rrnoft Krishti Mbret, Rrnoft Shqipnia”

Monsinjori Angelo Massafra, Arqipeshkev i Dioqezës Shkodër-Pult, Kryetar i konferencës Ipeshkvnore të Shqipërisë, bekoj shtatoren së bashku me ansamblin e 40 martireve përreth saj. Për arsye kohe dhe hapësire nuk po i përmendim te gjithë martiret me emër. Shpresojmë, që së shpejti Vatikani do të zyrtarizojnë kanonizimin e tyre, si martir të fesë dhe lirisë.

Nga të afërm të martireve u vendosen buqeta me lule dhe u ndezën qirinj, midis tyre kishte edhe disa dukagjinas, të cilët kurrë nuk e kursyen jetën për fe e atdhe. Kjo pjesë e veprimtarisë u shoqërua here pas here me muzikë nga kori i Katedrales dhe recitime të poezive: “Rrnoft Krishti”, nga Zef Ndoja dhe “Përmbi lumenjtë e Babilonit”, nga Luke Mllugja.

Mbyllja e veprimtarive të 25 vjetorit të meshës së pare përkonte me përfundimin e fazës së pare të rikonstruksionit të

sheshit para katedrales se Shën Shtjefnit.

Cilat ishin këto veprimtari në këtë vit jubilar?

1. Projekti dhe zbatimi i rikonstruksionit të kapelës së varrezave të Rrmajt e rrethimi i tyre në pjesën ballore nga famullia e Shën Shtjefnit, në bashkëpunim me Ministrin e Kulturës dhe arkitektin Artan Shkreli.

2. Zbatimi i projektit të oborrit të Katedrales së Shkodrës, duke e kthyer në një katedrale të hapur, pa rrethim, e hapur të prese kalimtare dhe besimtare, e hapur në një marrëdhënie të re me qytetaret.

Rrmajt, ku mori pjesë dhe Kryeministri. Gjate këtij viti jubilar u be promovimi i veprave të dom Ndoc Nikaj si klerik, filozof, gjuhëtar, krijues letrar, historian e publicist. Këto veprimtari kulmuan me promovimin e librit “Nëntori i Bardhe”, që i kushtohet 25 vjetorit të Meshës së Pare. Për të fol për librin, i pari e mori fjalën Dom Artur Jaku, administrator i famullisë, drejtuesi dhe iniciuesi i veprimtarive në këtë kuadër, i cili me punën e tij të palodhur, përkushtimin për misionin, ka fituar respektin e të gjithë atyre që punojnë me te apo të atyre që dëgjojnë ligjëri-

të rëndësishmet”.

Mbresëlënëse ishin komentet që iu bene librit nga profesoresha Nertila Haxhija. Ne këtë veprimtari foli edhe Ministria e Kulturës Mirela Kumbaro, e cila nder të tjera tha: “Ndjem e nderuar që marr pjesë në këto veprimtari gjurmëlënëse dhe e privilegjuar që mu dha mundësia në postin që mbaj, që të kontribuoj sadopak me fondet tona modeste, në rikonstruksionin e ambienteve të artit, kulturës dhe kulteve si në teatrin Migjeni, ambientet përreth Kishës së Madhe apo varrezat e Rrmajt. Ndhimesa ime nuk do të mungojnë as në të ardhmen për Shkodrën e artit, kulturës, sportit dhe qendër e katolicizmit”.

Ngjalli emocion tek të pranishmit, fjala e arqipeshvit Angelo Massafra, i cili mbasi vlerësoi të gjitha veprimtaritë në kuadër të 25 vjetorit të meshës së pare, mori edhe titullin “**Mirënjohje e Qarkut Shkodër**”, dhëne arqipeshkvise metropolitane Shkodër-Pult, të cilët iu dorëzua nga Kryetarja e Këshillit të Qarkut të Shkodrës, znj. Greta Bardeli. Monsinjori u angazhua për punë akoma më të mëdha në vitin 2016, si vit i shenjtërimit të Nene Terezës, në të cilin Nene Tereza e Martiret nuk duhet të jene refren i krenarisë sonë, por pjesë e punës sonë për të shëmbëllyer vlerat e dashurisë si të tyre, për të mposhtur sëmundjen e indiferencës.

Veprimtaritë e kësaj dite u transmetuan drejtpërdrejt nga TV “Star-Plus”, duke futur dhe teknologji të re, siç ishte kamera lëvizëse me dron. Ky aktivitet u shoqërua me muzikë operistike dhe koncertale nga kompozitorët më të mire shqiptar, Preng Jakova e Pjeter Gaci dhe muzikë kishtarë. Janë shume kuptimplote fjalët dileme të oratorit Jaku, që thotë: “*Sot po gëzojmë frytin e martireve, guximin e meshës së pare. Po pas 25 viteve a do të ketë ngjarje të kësaj besnikërie e dashurie? A do të kemi të rinj si Mark Çuni, Ipeshkev si Imzot Prendushi, meshtar si dom Ndre Mjeda, Motra si Marie Tuçin, politikan si Gurakuqi e Kaçorri, po si Fishta, shqipdashës si Ndoc Nikaj apo emigrant si Martin Camaj?! Në qofte se jo, nuk kemi punuar aq sa duhet, nuk kemi dashur aq sa duhet, nuk kemi dhuruar aq sa duhet dhe nuk kemi njohur asnjërin nga ata aq sa duhet*”.

Aristoteli thoshte: Nuk mjafton të ftohet lufta, por është më me rëndësi të organizohet paqja ...

Edhe këtu liria u fitua. Detyra më e vështirë është për ne, që ta bëjmë funksionale, ta bëjmë pjesë të realiteteve të përditshme shoqërore, familjare, politike dhe fetare.

Prele Shytani,
shkurt 2016



Projekti ishte ideuar nga arkitektja Ester Pagnoni dhe Simona Baziliko, zbatuar nga inxh. Lazer Pema, financiar nga arqipeshkvia Shkodër dhe ndihmuar nga Gjergj Luca, Gjergj Liqejza, Paulin Radovani, Mark Gjeka, Marjan Fierza, Vëllezërit Fusha, Gjergj Ejlli, Gjergj Livadhi, Gac Miculi e të tjerë.

3. U zhvilluan shume veprimtari Fetaro-kulturore, koncerte të ndryshme, porcionet me stendat e martireve, mesha jubilarë me 04 nandor tek varrezat e

met e tij plot horizont dhe inteligjence. Ai nder të tjera tha: “E kaluara na ka treguar se Nëntori ishte muaji kur Gjergj Kastrioti mbërriti në trojet e Arbrit, Ismail Qemali shpejtoi hapin për të ngritur flamurin në Vlore, Shqipëria u çlirua në nëntor dhe u rizgjua përsëri me 04 nëntor 1990. Kremtimi i Meshës së Pare, në varrezat e Rrmajt nga dom Simon Jubani, me 04 nëntor 1990, është një reference që të ngadalësoje pavëmendjen tone monotone, që jeton të zakonshmet dhe harron

LAHUTA



Lahuta është një nder instrumentet më të vjetër në Shqipërinë e veriut, që vjen mbas lëpushtres, pipzës, zymares dhe borisë, instrumente këto të ndërtuara me mjete rreth-anore natyrale. Lahuta ishte i vetmi instrumente që u lëvru nga rapsodia e jone e vjetër, mbas këngës majekrahrahu (ekapelle). Ky instrument i vjetër është moshatare me brez-at që kane populluar zonat e krahinat tona. Lahuta më e vjetër, që jam dëshmitar okular, është gjendur në fshatin Gjuraj-Pult- që kishte më tepër se dyqind e njëzetë e gjashte vite dhe me interesantja ishte që kupa e saj kishte formën e zemrës së njeriut, që tregon si të vetmin instrument, me të cilën njerëzit kane mundur të shprehin ndjenjat, lirismin dhe hallet e tyre, dhe harku i saj ishte imitim i harkut të shigjetës. Kjo lahute ishte pjese e pajisjes së shtëpisë së Pjeter Ndokes, në lagjen Telaj.

Lahute është një instrumente, e cila ka këto pjese:

- 1-Kupa,
- 2-Bishti i ngjitur me kupën, që në fundin e tije ka një vrimë, se vendoset një kunj, për të tendosur telin,
- 3-Kunji,
- 4-Harku, që mban të tendosur telin,
- 5-Teli-një bistak, me qime kali, që kur rrëshqasin telat mbi njeri-tjetrin lëshojnë tingullin e lahutës.

Druri, që është ndërtuar kupa e lahutës është e zgjedhur, zakonisht nga druri i Ver-rit (një drurë që rritet bregut të lumenjve apo përrenjve, shume i brishte për tu punuar, është druri që jeton më shume në ujë, por nga kumbimi është i përzgjedhur nga mjeshtërit e lahutës.

Lahuta më e vjetër dhe më e përdorur apo më origjinale dhe interesante është tek ai vendbanim, që është më i vjetër, siç është vendbanimi Gjuraj-Boks, që më i vjetër, se qyteza Boksit. Këngët e lahutës ndryshojnë sipas fshatrave e krahinave të Dukagjinit: Në fshatin Nënnavriq-Shale dhe në Nikaj-Tropoje, me lahute është vajtuar i vdekuri, vajtori solo ... Në Merture, në Theth, në Shosh dhe në Kir, me lahute është kënduar vetëm këngë

epike me variacione të ndryshme; ndërsa në Plan–Gjuraj dhe në Khan, lahuta ka qene e pakufizuar, është kënduar lirika, epika, me tematika të ndryshme shoqërore. Më e veçanta edhe këngët gazmore- humoristike, duke mbete argëtimi më i bukur në gostie e dasma. Në fshatin Gjuraj, thuhet se, dasma nuk ka qene e suksesshme dhe nuk është mbaruar pa u gjet kënga që bën nusen me qeshe. Në këtë rast, rapsodi lahutar është veshur me rroba të grisura, ka vendosur maskë, është veshur si grua e të tjera ... vetëm e vetëm me sjelle, me lahute humorin e bukur që bashke me putirët kane qene argëtimi më i bukur.

Lahutarët janë përmendë me shtëpia, që kane e pas të trashëguar me gen, këtë tradite ..., jo kushdo mundet të jete lahutarë, sepse duhet zëri, që vetëm dikujt ja fale natyra, nuk ja fale të gjithëve. Zëri, në përgjithësi, është i trashëguar, disa e kane në gjak, siç thotë



populli. Kur një djalë, sapo kishte lind, pa u lidh ende në djep, ishte tradite, me i vendos lahutën te koka, që ai të bëhej lahutar.

Lahutarë, që kane lanë emër në breza janë shume dhe sipas gojëdhënave, munde ti ndajmë sipas fshatrave dhe krahinave.

Në krahinën e Shalës, në fshatin Theth, është lahutari më me emër i Dukagjinit, Gjergj Pellumbi, Fran Micani, Gjergj Shyti, Martin Pisha, Ded Nrethi. Në fshatin Nennavriq, Zef Lulashi, Lulash Zefi, Pjeter Shytani, Gjergj Bala, Kol Dema, Prele Gjeloshi e Ndue Shytani. Në fshatin Abat dhe Nicaj, Gjelosh Kola, Prele Martini, Dede Metushi, Marash Bardheci e Mhill Çuni.

Në krahinen Nikaj-Merturit ka pas lahutarë me zë, që kane lanë emër, Zef Avdija, Miter Kola, Mark Mitri e Syke Pappleka.

Në krahinen e Shoshit, lahutari i njohur në festivale, ka qene Gjergj Marku dhe Kole Gjoni, Gjon Kosteri.

Në krahinën e Pultit, në fshatin Kir mund

të veçojmë lahutarin, rapsodin dhe hokatarin Nike Zogu, Shan Marku, e Marash Pali; në fshatin Khan kemi lahutarët Dedush Maluku, Dede Shtepijani, Miter Keqi, Pjeter Mjeda e Mehil Lushi; në fshatin Plan kemi Stake Mirashi me djemte (Prendashi, Mehilli, Zefi e Ndoci), shtëpi me tradita të vjetra për lahute, fyell e tjerë. Shume i talentuar ka qene edhe Leke Ndou po nga ky trung, që është vlerësuar dy here me çmimin “Laurat” në festivalin Folklorik të Gjirokastrës, si dhe Dode Preka,-Than, që ka imituar në mënyre të shkëlqyer lahutën me goje. Nga ky fshat janë edhe Lulash Plavra, Prele Marku, Gjergj Lisi e Dede Sokoli. Fshati Gjuraj, që mund ta quajmë djepin e lahutës, ka pasur shume lahutarë me emër, Tome Kola, Lush Toma, Dede Lushi, Gjelosh Kola,.... e më vone Zef Tefa, Nikolle Lulashi, Ndoke Leka, Leke Koçeku, Gjergj Staka e të tjerë.

Lahuta është një instrumente, që ka mbar-tur me vete krejt zinxhirin e pa këputur të historisë së kësaj Zone, udhërrëfyesja më e sakte e ngjarjeve, zakoneve e traditave. Lahutari kur ka kënduar një këngë trimërie, historike, nuk ke pas shanse me ndryshua asnjë trimëri, ngjarje lufte apo ngjarje historike ... Pra, është dëshmitarja më e sakte e historisë sonë.

Lahute është kombinuar shume bukur me Lëpushter (Gjethë malit), që përdorej shume kur bjeshkataret dilnin në bjeshke; është kombinuar shume bukur me fyell, me zymare dhe kohen e fundit edhe me çifteli e sharki. Shume të përhapura kane qene në këto ane këngët e ciklit të kreshnikeve, që kur janë kënduar, sipas zonave ka ndryshuar dialekti apo melodina, ndërsa teksti i tyre ka qene pothuaj i njëjtë.

Këngët kane qene edhe të shkurtra edhe të gjate sipas historisë që ka ndodhur, që kane qene nga 5 minuta deri në 45min. Rendi i lahutës në Gosti, në festa, në dasma apo kuvende ka qene e dyta mbas këngës pa shoqërim (majakrahu ose këngë kushtrimi). Menjëherë pas kësaj e ka pas radhën lahuta.

Këngët e kushtrimit ose majakrahu ose si i thonë pa shoqërim ose në gjuhen apo klasifikimin muzikore, që quhen-Ekapelle-janë më të vjetrat, të cilat janë manifestuar në kohet më të lashta, në momentet e veçanta në jetën e tyre kolektive, në bjeshke, në gazmende, në dasma e të tjera. Këto këngë janë kënduar edhe në raste thirrresh dhe përgjigjesh zona me zone, fshat me fshat, kodër më kodër, që në raste luftërash kanë biseduar me njeri-tjetrin pa u kuptuar nga të tjerët, nga armiku. Karakteristika e këtyre këngëve ka qene zëri brilant i këngëtarit, që e ka nise këngën dhe pas një thirrje është kombinuar me këngëtarin tjetër, me një, dy ose më shume, duke u unifikuar në një zë të vetëm. Përmbajtjet e këtyre këngëve kane qene një përmbledhje e shkurtër, në tre ose në katër vargje, me nga

Shoshit me gjithë virtytet e mira e të mrekulueshme të shoshjaneve nder vite. Të shpalos vetëm lavdinë e tyre.

Ndodh shpesh, që duke lexuar romanet, njerëzit të formojnë ide jo të drejta për ndonjë personazhe apo ngjarje. Kështu, siç duket ka ngjare edhe me romanin “Guxo ...!”. Mua me vjen shume keq, që jam keqkuptuar dhe për këtë ju kërkoj falje dhe mirëkuptim nga lexuesit. Unë jam nisur vetëm nga qëllimi i mire dhe deklaroj, se ato personazhe apo ngjarje, që janë keqkuptuar, janë vetëm fantazi, krijim pa asnjë paragjykim. Pra, nuk kane ekzistuar në të vërtetë. Pra, janë vetëm trillim i fantazisë së shkrimtarit, asgjë më tepër.

Nëse Zoti do të me jap edhe disa vite jete, unë prapë do të shkruaj për Shoshin e shoshjanet, sepse gëzohem shume për ecurinë e tyre. Gëzohem, se shume shoshjane, sot po e zbukurojnë Shkodrën dhe atdheun, janë bere biznesmen, intelektual të shquar. Me gëzon fakti, që nipat, kushërinjtë e miqve të mire të mijë, Bales, Markut e Mushakut, sot janë shkodrane të nderuar dhe të shquar. Gëzohem, që nipi i Bajraktarit, Ndoci, pas ardhjes së demokracisë u shqua si drejtues komune, si drejtues institucionesh e dikasteresh, sidomos emrin e mire, që fitoi si kryetar e misionit fisnik të faljes e gjaqeve. Ai, pinjoll i një familjeje të persektuar dhe torturuar

tete rrokje, të një trimërie të paramenduar. Këto fjale janë shkëputur nga rapsoditë e krijuara nga vete populli i këtyre aneve, prej të cilave u janë marre katër vargje, nëpërmjet të cilave tregojnë thelbin kryesore të qëllimit. Ja disa prej tyre:

-Pal Gjoka shkoj te daja / zot ku rrin Sulejman Aga / n’ koder t’ Kirit n’ ato çadra, ose-

Nike Vuksani veshe mitanin / kam dy fjale me t’ gucinjanin / nuk po m’len me ndez duhanin / thot ma prishe ramazanin-e të tjera.

Gjithmonë kënga majakrahu e ka hape dasmën dhe e ka mbylle. Kur ka mbërrite nusja, është prite me këngë majakrahu dhe është shoqëruar duke qite pushke e shyqyrit. Gjithashtu, kur është nise rakia, është këndua kënga majakrahu nga nje prej shtëpie dhe pastaj i kane hequr duvaku nuses. As rakia nuk është çua pa u këndua kënga e mbylljes, pastaj është çua rakia dhe kane sjell buken.

Putirët e kane pas rendin mbas gjysmës së dasmës, që janë shoqëruar ne dy grupe-miq të me vendasit-duke u ndërthurur me fjale mikpritëse, me falënderime dhe duke u zgjeruar edhe me gërgame të veshur me humor dhe jo në pak raste kane pas përfundime tragjike, nga vete pija e kontrolluar dhe nga vete këngëtaaret, që kane fole fjale të fyese. Ajo, që i ka mbylle putirët, ka kenë kënga e fundit, kënga e majëkrahut.

Në një dasme, kuvende apo gëzime e festash, në të cilat ka pas miq nga krahinat apo fshatrat e largëta, këngën majakrahu e ka hap një prej vendit pritës dhe s’ka pas të drejt morale, të këndoi këngë të katundit të tij, por ka kënduar këngë për miqtë, që janë prezent. Edhe nga miqtë kane kënduar këngë për katundin pritës.

Këngën majakrahu janë kenë të radhës, por janë këndua nga ata që kane qene të dhënë për të kënduar këngën majakrahu. Zakonisht, kënga majakrahu shume pak ka ndryshua në fshatrat e krahinat e Dukagjinit, në melodi, por ndryshimi ka kenë karakteristik e zërave ose regjistrave të zërave.

Në krahinën e Pultit nuk është përmendur ndonjë rast, që gratë kanë kënduar këngë majakrahu. Në krahinën e Shalës janë përmendur disa raste. Këngët pa shoqërim, që kane kënduar gratë, kane qene këngë vaji malit, këngë e valle dasme, në përcjellje të vajzës apo në marrje të nuses. Të vetmet këngë me shoqërim, që grat kanë këndua, kane qene këngët me tepsi, që më të spikatura kanë qene në Plan dhe në Xhan e shumë radhe në Gjuraj. Këngët pa shoqërim, të përmendura kane qene këngët e kositjes së burrave në Plani, këngët e malit të Gjurarjve dhe te shatit, kur prashitej misëri. Kënga më e përmendur ka qene kënga majakrahu e fshatit Plan, e fshatit Kire, e Pogut e të tjerëve.

Përgatitë nga kantautori, FRAN KODRA

BURRËRIA, BUJARIA, NDERI DHE MORALI, KANE QENE TË LARTA E TË PAPËRLYER PËR DUKAGJINASIN



Si shkrimtar jam i kënaqur, se i kam shërbyer atdheut dhe Shkodrës, me shkrimet e mija të çdo gjinie letrare. Librat dhe dramat e mija kryesisht trajtojnë temat e Veriut e sidomos të Dukagjinit, sepse kjo zone më ka frymëzuar gjithmonë për burrërinë, patriotizmin, nderin dhe besën. Dukagjini dhe sidomos krahina e Shoshit kane qene dhe janë frymëzimi im. Këtë dashuri për Shoshin e kam mbjell në zemër që në fëmijërinë time, sepse kam pasur fatin të më jap mësim në gjimnazin e Shkodrës, shoshijani i madh, profesor Kole Prela, deputeti trim, që diktatura komuniste e pushkatoi. Me vone zura miqësi të ngushte me tre burra të mençur dhe të ndershëm, Bal Markun, Mushak Deden e Mark Ndojen. I kam dashur shume dhe më kane dashur shume. Kam ngrënë

buke dhe kam fjetur në shtëpinë e tyre, ashtu dhe ata, Bala, Mushaku dhe Marku kane ngrënë buke dhe kane fjetur në shtëpinë time. Ata i falënderoj për jete, sepse prej tyre njoha një zone shqiptare të shquar për patriotizëm, nder dhe burrëri. Ata më frymëzuan të shkruaj shume në poezi dhe në proze, poema, drama, tregime e romane për

Dukagjinin dhe dukagjinasit, sidomos të krahinës së Shoshit, që e dua aq shume.

Vitet e fundit, dy romanet e mijë “Pengu i Diellit” dhe “Guxo ...!” trajtojnë temën e Shoshit dhe shoshjaneve. Me romanin e pare, duke përshkruar jetën, vuajtjet, por dhe trimëritë e ndershmërinë shoshjane, unë duke krijuar personazhe me emra të ndryshëm, të krijuar prej meje u kam veshur atyre tiparet e dy personazheve. Në të parin flas për jetën e Bal markut, ndërsa ne romanin e dyte “Guxo ...!”, flas për një shoshjane, që duke u nisur nga hiçi, duke bere pune të rëndomta arriti të realizoje ëndrrën amerikane dhe sot është një nder figurat e shquara shqiptare në Miçigan të SHBA. Duke përdorur atë, që quhet licenca poetike, unë, në këtë roman, në romanin “Guxo...!”, personazheve u a ndërroj emrat, madje dhe krijoj personazhe, që nuk ekzistojnë, ngjarje dhe episode, që nuk kane ndodhur, por janë vetëm krijese e shkrimtarit. Jam përpjekur të jap panoramën e

barbarisht nga sistemi komunist. Pra, që do të kishte një milion arsye për të marre hak. Ai, përkundrazi beri të falen dhjetëra gjaqe, beri që të shuhen dhjetëra e qindra sherre e thashetheme. Po, kështu, gëzohem, që nipi i Bal Markut apo kushërinj e të ndjerit e të urtit Mark Ndou, sot janë njerëz të nderuar në Shkodër. Më tepër gëzohem për rinin shoshijane, që po shkollohet dhe nesër do të jene ajka e Shkodrës, duke ruajtur të gjalle në mendje e në shpirt virtytet e larta të dukagjinasve, burrërinë, bujarinë e sidomos nderin dhe moralin, që gjithmonë ka qene i larte dhe i papërlyer.

Kështu e njoh Unë, Dukagjinin dhe Shoshin si pjese e tij, kështu e dua të pastër e të papërlyer, si kurore e virtyteve të shenjta shqiptare. Këtë mendim kam dhe do të kem, gjithmonë deri sa të jem gjalle. Ata, që mendojnë ndryshe për Dukagjinin, Shoshin apo për çdo krahine tjetër të malësive tona, do të jene tabele qitjeje për mua dhe nuk do lejoj asnjë të përlyej sadopak dashurinë time të përjetshme, për këtë zone e për këtë krahine dhe njerëzit e saj.

Ky është principi dhe betimi i im.

FADIL KRAJA
Shkodër, me 2 shkurt 2016

FREDERIK RESHPJA, TURPI I SHQIPERISË ZYRTARE

- MEMORSITIKË ME RASTIN E 10 VJETORIT TË VDEKJES -

Me 17 shkurt të vitit 2006 pushoi së rrahuri tikt-taku i zemrës së poetit dhe lirikut të dllirë, Frederik Rreshpja. U bene plot 10 vite shpirti i poetit gjeti prehjen në një botë më të mirë e më humane, se ajo që kaloi në atë injorancë dhe indiferencë cinike që e la të vdesë në një vafëri dhe mjerim të tmerrshëm.


10 vite më pare u nda prej ai, që Hans-Joachim Lanksch e ka quajtur poetin, që qante edhe për zogjtë dhe që u shpjegoi atyne që “edhe unë jam pa fole”. Shqipëria zyrtare nuk dha poetit të madh të saj një fole!! Pena qau mjeshttrin, lirika shqiptare humbi shëlbuesin, miqtë dhe adhuruesit u trishtuan për ikjen e Fredit, ndërsa shpirti i tij fluturoi si pëllumb, i shko i drejt parajsës, sepse për një njerëzi aq shpirtmirë sa ai, Zoti ka krijuar parajsë botes së andejme (jetës së pas osur).

“**Nuk di se më ka mbetur ndonjë gjë në këtë botë, që të më gëzojë. Gjithçka kam dashur e kam humbur**”, shprehej poeti në vigjilje të largimit të tij nga kjo jetë. I dyzuar mes reales dhe fantazisë, i pikëlluar dhe moskokëçarës për fatalitetin e jetës së tij ai, vazhdimisht kohët e fundit këndonte refrenin e vdekjes së vet dhe i lutej Zotit që ta binte sa më shpejt. Aq pamëshirshëm e kishte dhunuar aventura e mbijetesës sa poeti: thoshte “Zoti nuk më do” dhe i pyetur se pse përgjigjej: “Sepse nuk po më merr shpirtin”.

Më në fund lutjes përgjëruese të poetit, Zoti i tha amin duke e çliruar përfundimisht “Prometeun” nga vuajtjet mizore të kësaj bote, duke e larguar nga realiteti ynë banal, duke i dhënë paqen e munguar shpirtit të tij atje lart në Olimp in e shenjtë të poezisë. Jeta e Ferderik Rreshpes është një dramë e pa shkruar, një dashuri e tradhtuar, një dete i trazuar, një meteorit i dalë jashtë orbite, i shkëputur dhe i rrëzuar në sterro. Jeta e Frederikut ishte aventura dhe plagë e pashëruar. Ai provoi sklavërinë, prandaj e donte dhe çmonte aq shumë lirinë. Ai provoi vetminë dhe urrejtjen, prandaj zemra i digjej flakë nga dashuria. Ai kishte provuar përçmimin, prandaj e dinte sa e rëndë është përbuzja. Frederiku kishte provuar ferrin, prandaj e donte dritën e parajsës. Ai kishte provuar fluturimin drejt lartësive dhe e dinte sa e rëndë është të zvarritësh pa krahë. Frederiku ishte marrë me politikë dhe dinte mirë se çfarë është kurvëria. Ai kishte provuar të bëhej milioner dhe e dinte sa e fëlliqur dhe e dobishme është paraja. Provoi të jeto i edhe pa as një kacille duke shijuar sa e hidhur dhe e pa dinjtet është varfëria . Sakrifikoi gjithçka duke kënduar si bilbil këngëtar ndonëse ishte i vetëdijshëm se, poeti në këtë botë të pistë e arkaike nuk vlen as sa një putanë. Ai dinte se njerëzit e zakonshëm ndofta nuk e konsideronin njeri, por ai nuk çante fare kokën pasi askush nuk mund të mos e quante poet të lindur. Ai lindi poet dhe i tillë mbeti derisa mbylli sytë duke fituar pavdekësinë në panteonin e letërsisë moderne shqiptare.

Fredi ishte një mesoburrë me sy të mprehtë që rrezatonin zgjuarsi, vazhdimisht shfaqej me një kapele republike herë si zotëri, herë si zhongler cirku. Cigaret “Malbora “ose “Slims” i kallte gjithë e fsh në seri, njëra pas tjetrës, duke i shoqëruar gjithmonë me nga një gotë, në ndonjë kafene të qetë në vetminë e tij të preferuar. Mbante një çantë të zezë të hedhur krah e qafë, në të cilën natën “fatlume” të vdekjes së poetit iu gjet i rezervuar gjithë “thesari” i jetës së tij. Disa hieroglifë të pa deshifrueshme poetike të shkruara në copëra letrash të çuditshme gjysmë të zhu-bravitura. Vitet e fundit, vuajtjet e mëdha të shoqëruara më një seri komplikacionesh të rënda shëndetësore e kishin plakur dhe dërmuar përpara kohe. Fytyra e tij plot rrudha

ngjasonte me një hartë izeipesh barike. Me atë mjekër të pa rruar, me ata flokë të kërleshur, me krahët e mpirë, gjysmë të paralizuar dhe trupin e kërrusur ngjante si Odiseu i plagosur nga stuhitë duke kërkuar Itakën e



humbur. Ngjasonte si një fisnik i mjerë dhe i pa fat, pa një banesë ku të fuste kokën, pa një shtrat të vetin ku të shtrinte trupin e ligështuar e të mpirë nga paraliza, pa një pension dhe as një lloj ndihme. Pse u braktis aq çnjerëzisht dhe si u la të vdiste në atë vetmi të frikshme?! **O Zot! Nuk kam as ku të vdes**”, shkroi poeti! Ai lëvizte hotel më hotel i zhytur në borxhe e skamje të thellë. I harruar nga mosmirënjohja e shoqërisë, shtetit dhe e gjithkujt si qenie e parakohshme, të cilën nuk e meritonim, si mermer i thyer i “Perëndisë së Humbjes”, ashtu si e quante vetën në një varg të vjershave të tija pikante.

*E çdo të përfitoja tjetër përveç luftës
I ndjekur nga ky fat budalla?*
*Vërtetë kam fituar shumë pak në këtë jetë,
Por humbjet i kam pasur të mëdha*
Ai ishte një njeri i çuditshëm, tip i vështirë dhe tekanjor, mendjemprehtë dhe inteligjent, fjalë ëmbël dhe idhnak, zotëri dhe shtegtarë, i thjeshtë e mospërfillës, thumbues dhe ironik. Ironia ishte një nga armët e tij të përhershme, për të cilën nuk mund të thuhet me saktësi, ishte ofensive apo defensive. Rreshpja ishte një polemist sfidant i aftë të debatonte më këdo mbi filozofinë, politikën, sociologjinë, estetikën, paranë, gotën dhe universin femërorë. U shqua si publicist i mprehtë e guximtar, prozator, përkthyes, humorist i veçantë i stilit konician, në rini pati talent të veçantë edhe në pikturë. Lëvroi edhe pati sukses edhe në gjininë e përrallës. Ferderik Rreshpja posedonte energji të mëdha në vetvete. Ai gjithmonë mbeti i shkujdesur dhe moskokëçarës i mënyrës habitore, i lirë në mendime dhe i vetëdijshëm se sa më shumë që ta kërkonte të vërtetën aq më pak do ta gjente atë. *“Unë kam lindur i lirë dhe skandal”,* thoshte liriku dhe në të vërtetë gjatë gjithë jetës mbeti rebel i pa ndreqshëm. Aventura spektakolare e artit e shpuri në disidencë, disidencë që e rrëzoi nga lartësitë dhe e gremisi në humnerën e erttë, ku nuk depëronte as drita e diellit. Kundërshtarë i kahershëm i diktaturës nga e cila u ndëshkua me afërsisht 20 vjet burg. Sigurisht që fajin për këtë nuk ia hidhni demokracisë?...
— *Jo, aspak. Por mua më vjen keq që kjo demokraci që po ndërtojmë ra pikërisht në dorën e renegatëve të komunizmit. Megjithëse botuesi i parë i Biblës latinisht shqiptar ka qenë, ne nuk e kemi ende, sikundër edhe Kur’anin!... Tek ne fatkeqësisht ka qenë përkthyer vetëm Marksi, Englesi, Lenini e Stalini... Për çudi, u bëmë një popull marksist! Ne, të burgosurit e ndërgjegjes jemi vetëm 1600 në Shqipëri. Kurse këtu dalin tani 2 milionë të*

persekutuar. Këta faqezinj, që gjoja po bëjnë demokracinë, janë bërë ministra, janë bërë kryetarë partish, edhe pse të gjithë kanë qenë në pozita. Këta po formojnë një imazh shumë të keq për demokracinë

Si i burgosur politik asnjëherë nuk rrëmbej as flamurin e heroit as të disidentit. Atij i ngjallnin neveri të jashtëzakonshme ata sanguin që për diktaturën kishin kënduar si gjelat, ata që e kishin goditur e quajtur surrealist, dekadent, ata që deri dje e quanin vetën leva të parisë për edukimin komunist të brezit të ri, ndërsa sot hiqen si disident të shumëvuajtur profet të rremë të një imoraliteti të ri .
Skillevër mosmirënjo-

*hës, ju deri dje
Te këmbët e diktatorit jeni shtrirë
Dhe më keni quajtur mua skandaloz
Për fjalën time të lirë ...
Tani shkruani për mua përralla
dhe i varni si pranga nëpër mure
Skillevër mosmirënjohës dhe të marrë
Kope hipokritësh servilë
Unë muret dhe prangat i pështyj
Unë kam lindur skandaloz dhe i lirë .*

Duke qenë antikonformist i lindur deri në flijim gjithmonë notoi kundër rrjedhës, kurrë nuk ia ktheu shpinën erës dhe mbeti përherë opozitarë i çdo qeverie, i pamerakosur dhe i pafrikësuar për të vjellat shigjetare që goditën në çdo drejtim. *“Vërejtja që më bëjnë është kjo: Ti Fredi u persekutove nga diktatura, tani himnizo pushtetin e ri. Mua më çuditë kjo gjë. Si shkrimtarë unë e kam pasur për detyrë të mos bëj himne. Himnet i bëjnë sharlatanët. Vendi im është tek populli, tek buka, tek dhembja e tij, tek e ardhmja e tij “*

*Shkoi te lumi ku qajnë ciganët
Për rërat e largëta me dritë
Po pse dreqin jam gatuar kështu
Të grindëm me tëra qeveritë?*
Rreshpja ishte një poet i natyrshëm lirik me nuanca epike, ndër të parët modernist të poezisë dhe letërsisë shqipe, një poet delikat i ndjenjave njerëzore joshës dhe i pashlyeshëm. Kopshtarë i palodhur i zgjerimit deri në përsosje të fjalorit dhe stilit poetik. Thesari më i madh i Rreshpes gjendet pikërisht tek stili epiko-lirik i poezive të tij të shkruara në çastet më dramatike të jetës, që zotërojnë pajonin, ndjenjën, dhe frymën e tij letrare. Metodologjia e tij e të shkruarit është po aq moderne dhe bashkëkohore sa edhe subjekti që zgjedh.

“Në punën time laboratorike përpiqem të gjej poetikën në çdo objekt apo ngjarje”. Unë nuk shkruaj për vete, por për të tjerët. Unë jam njeri tepër i rëndomtë për të shkruar për vetën time, shprehej Rreshpja mes miqsh kohë më parë”. Në tematikën e poezive të tij mbi-zotëron humbja, dhimbja, vetmia, ndjenja e lindur e poetit për fjalën e lirë. Poeti këndon për lulet, zogjtë, lojërat e femërisë, për shtegtime ciganësh, ujqër të vjetër pusish, dimra të acartë me borë të thinjur e stuhi, beharë plot ngrohtësi e diell, vjeshtë me vdekje gjethesh e ylberesh, det i dallgëzuar me lot, perëndi ilire të skalitura në mjegulla, profet të rremë, jeniçer plaçkitës nën gjysmë hënë, këngë lahute, dhimbje, dashuri e humbur, trëndafilat e drurëve të vdekur. Aq sa e paqetë dhe trazuar

ishte jeta e poetit nga jashtë aq e përshkonte poezinë e tij një frymë e qetë e rregullt dhe harmonike. Poezia e Rreshpes është një simfoni e nektartë ndjenjash e interpretuar në mënyrë të magjishme dhe e ndërtuar me një stil të pangjashëm me askënd tjetër. Vargu është tërësisht i lirë i shpenguar dhe i përkushtuar prej një frymëzimi të rrjedhshëm më një vizion të thekshëm sa naiv, fëmënor aq edhe mistik. Në pa mundësi për të analizuar poezinë e tij në kompleksitetin që përfaqëson, ajo që dua të nënvizoj, është se Ferderik Rreshpja ishte një poet i madh ëndërrimtarë, që e ndiqte nga pas një ndjenjë vetmie, ndjenjë që buron nga rrënojat psikologjike dhe ekzistenciale të individit. Ferderik Rreshpja ndonëse nuk pati shumë miq nga lloji i poetëve, ndonëse nuk pati kurrë marrëdhënie shumë miqësore me masmediat, ndonëse e dënuar të mos botohej dje, ndonëse pak e proklamuar sot, gjithsesi poezia rreshpjane ka marrë vlerësimet: *si poezi e dorës së pare, poezi e kalibrit Evropian, fine, surreale me një pjesë të ftohtësisë klasike. Rreshpja është poet sa lirik aq edhe tragjik. Mbret i tokës së poezisë. Bohemi i fundit i poetëve shqiptarë. Kapiteni i vjetër i anijes poetike. Poet me talent gjeniu krejtësisht modern. Fëmijë i pa dëshiruar i poezisë së kohës. Brillanti i poezisë. Korpusi i tij poetik është ndër të paktë që ka dalë t’i mbijeto i poezisë nën diktaturë e të tjera, e të tjera*

Lirika e Rreshpes, është një shejze plot harmoni, plasticitet dhe frymëmarrje të gjerë, është një vegim rrezellitëse, një pegas me krahë engjëlli që fluturon ne galaktikën e poezisë. Është një burim i fuqishëm jonik drite e mbingarkuar me amplituda metaforike, plot dashuri, dhimbje shprese dhe pikëllim të thellë Lirika e Rreshpes është një afreske plot ngjy-rime të thella poetike që lidhen me jetën vdekjen, perënditë, fatin, dashurinë statujat, trëndafilin, shirat, hënën, djajtë dhe engjëjt. E gjithë lirika poetike e Rreshpes është e mbushur me dashuri dhe pse me situata absurdi, me lirizëm tragjik. Rreshpja është poeti i mallëngjimit, dhimbjes, humbjes dhe trishtimit që e derdh në vargje të një bukurie të rrallë.

Ferderik Rreshpja në poezinë shqipe nuk solli një vepër shumëvëllimësh si jo pak bashkëkohës të tij. Ai solli poetin dhe lirikun e madh që i mungonte kësaj poezie. Me të pushuar së rrahuri akrepi i zemrës së lundërtarit të vjetër të deteve, poezia shqipe do të ndihet më e varfëruar pasi bashkë me Fredin shkoi edhe një lloji liriku i papërsëritshëm, shoqin e të cilit nuk kemi shans ta rikrijomë kaq shpejt, Fredi iku, por la pas poezinë brilante si zgjatim në kohë i konstulucionit të De Radës, Mjedës, Lasgushit e Camajt, të cilët së bashku me Rreshpen përbëjnë galektikët e lirikës sonë. *Peizazhet e Martin Camajt dhe Frederik Rreshpes, pasqyrojnë gjendjen e tyre të brendshme. Poezia e tyre na tregon gjendje individuale shpirtërore ata nuk kanë bërë kurrë ndonjë kompromis me regjimin dhe doktrinën e tij letrare,* ka nënvizuar Hans-Joachim Lanksch përkthyes i letërsisë shqipe në gjuhën gjermane

Në të gjalle, e në të vdekur Ferderik Rreshpja është turp i Shqipërisë zyrtare, ai vazhdon të mbetet jashtë teksteve shkollore si dje në komunizëm dhe sot në kapitalizëm pasi zyrtarizmi i poezisë dhe letërsisë në Shqipëri ndjek kritere jashtë letrare.

Ferderik Rreshpja është Turp i Shqipërisë zyrtare, që nuk mendon fare as për ndonjë statujë as një shtëpi muze për emblemen e lirikes shqiptare.

**Prele Milani,
Poet studiues dhe publicist**

FREDERIK NDOCI

**NËSE MPOSHTET PIRATERIA DO JEM I LUMTUR
EDHE PO VDIQA, KONCEPTI IM PËR MODERNEN DHE
KOMPROMISET QË PO NXJERRIN FILMA “KËRTOLLË”**

Mbetet një nga artistët më të vlerësuar me krijimtarinë e tij, këngë që në skena brenda dhe jashtë vendit kanë njohur suksesin. Për kantautorin Frederik Ndoci muzika gjithmonë krijohet për të përcjellë më të mirën e saj. Vlerësuar si një multi-artist pasi talentin e tij e ka shfaqur dhe në gjini të tjera të artit, këtë muaj të parë të vitit ai vjen në një rrëfim mbi aktivitetet e jetës artistike si dhe projektet në të ardhmen.

Në bashkëbisedimin e kantautorit Frederik Ndoci thekson, se nuk kanë qenë të pakta angazhimet me koncerte të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. Por ndërsa ndalet mbi gjendjen që po kalon sot vendi, ai pohon se tashmë do të vijojë jetën e tij në Amerikë bashkë me familjen e tij. Për projektet e tij të reja në muzikë, ai pohon se në planet e afërta janë dy këngë të reja, që do ti prezantojë për publikun. Por për atë që shikon sot në zhvillimet e jetës artistike në vend, artisti i njohur shprehet se arti në Shqipëri është krejt privat nga individit dhe nuk ka ndihmë sot për artin dhe artistët sa duhet nga Ministria e Kulturës. Kritika ka dhe mbi festivalin e këngës në RTSH, që sipas tij nuk është e drejtë që shpall vetëm një këngë fituese dhe e çon në “Eurosong”, por 6, që janë në vendet e para të konkurojnë dhe në festivale të tjera në botë.

Gjithmonë me aktivitete dhe angazhime në muzikë, si po zhvillohet jeta artistike këto kohë?

Si për të gjithë artistët e tjerë kuptohet jemi në Shqipëri me të mirat dhe të këqijat e saj, por isha i çuditur sepse unë u ktheva nga Amerika në fillim të korrikut dhe pata disa prenotime që ishin bërë dhe më parë për aktivitete të ndryshme, dhe përnjëherë u hap një bumerang pune i jashtëzakonshëm, tërë korriku, shtatori, tetori plot punë. Por nga data 19 dhjetor deri më dh-

jetë janar kam qenë dy ditë punë, një ditë pushim. Plot aktivitete të ndryshme, nata e Vitit të Ri, etj. Por planet e mia janë që bashkë me familjen nga muaji shkurt unë të largohem për në Amerikë. Po përgatis dhe folenë time atje, që të vijnë fëmijët dhe gruaja që të vazhdojmë jetën tonë atje. Nuk është se do ta lë Shqipërinë për fare, por 8 muaj në vit do qëndroj atje.

Pse erdhi vendimi për t’u zhvendosur në Amerikë me familjen?

Unë vetëm mund të jetoj në Shqipëri dhe gruaja po ashtu, por kemi dy fëmijët, që ata nuk kanë ndonjë të ardhme në Shqipëri. Më vjen keq që e them këtë, sepse nuk kam asgjë politike, por nuk kam çfarë flas më, nuk kam më mundësi të merrem me politikanët, me humbur kohën kot. Gjithkush e di vetë se çfarë bën, nëse do të mbesë në histori për mirë apo keq. Për mua nuk ka ndonjë të ardhme fëmijët e mi këtu. Politikanët vijnë në pushtet për të konsoliduar ato prona të tyre dhe lekët e tyre, asnjë nuk vjen për shqiptarinë, ka ikur idealizmi. Por dhe tërë politikanët në botë kështu bëjnë, në një mënyrë ose në një tjetër. Mënyra se si ato kanë mundësi ti rregullojnë punët është tjetër, e jona është tjetër.

Po flisni për politikat, por në jetën artistike çfarë ka bërë Ministria e Kulturës. Ju jeni artist, u jeni artist, çfarë mund të na thoni?

Ministria e Kulturës duket se nuk ka bërë asgjë. Kanë marrë pjesë ndonjëherë në ndonjë veprimtari timin, por që të kenë bërë gjë për mua? Harrojeni! Asnjë fond, as me të thirrur ndonjëherë që eja si artist për veprimtari. Artistët në Shqipëri kanë potencën të jashtëzakonshme dhe lufta për të mbijetuar me të bukurën në art ndjehet shumë konkretisht në Shqipëri. Pra çdo artist në mënyrën e vet e thotë fjalën e tij, keq ose mirë. Shikojmë festivale private

apo shtetërore që bëhen. Ka dhe një lloj cilësie, por sa ndiqet, sa është predispozita e njerëzve për ta ndjekur këtë prurje të re të artit, kjo është për të ardhur keq. Këtu merr vesh se vetë politika është një art, njerëzit ngaqë nuk kanë mundësi të merren me artet e tjera merren me artet e politikës. Nëse unë do të isha Ministër Kulture do të thosha plot gjëra se çfarë mund të bëhet më mirë. Përshebull, unë nuk paguaj asnjë artist në teatër apo diku tjetër nëse nuk ka kontratë pune. Ministria është një dikaster, që ka një buxhet, dhe ky buxhet varet se në çfarë krize apo lumturie është Kryeministria, shteti. Nëse ata kanë ndërmend për të dhënë buxhetin “X” para kur je në krizë të madhe, buxheti ka punën e tij, dëshirë dhe mundësi për të bërë gjithçka gjithkush e do, por nuk ka mundësi. Pra arti në Shqipëri është krejt privat nga individit. Nuk ka ndihmë sot për artin dhe artistët sa duhet nga Ministria e Kulturës.

Çfarë shijesh ju la festivali i fundvitit në RTSH?

Festivali në RTSH, e kam ditur apriori që do ta fitonte Eneda, sepse është një artiste shumë e mirë. Kënga e saj nuk ishte e keqe, por pjesëmarrësit e tjerë e dija shumë mirë pasi është një festival ku nga 30 këngë 29 hidhen në pleh, ku gjithsecila prej tyre hyn në garë për të qenë në “Eurosong”. Po në natën finale 29 këngë hidhen në pleh. Kjo është e bukur? Mos harroni mundin, paratë për krijimin e këngës? Vite më parë i kam bërë një propozim, pse nuk e bëni festivalin e RTSH, ku 6 çmime të para të shkojnë në festival kënge në Ballkan, festival rinie rock n’roll në një vend tjetër, e të tjera Mos të kemi pjesëmarrje vetëm në “Eurosong”, që dhe dihet se çfarë çmimi jepet. Siç ka dhe atje patriotizma dhe miqësi që dikush fiton festivalin, edhe këtu ka nisma që ta fitojnë festivalin, dhe këngët e tjera të hidhen në pleh. Ju kujtohet kënga që kam kënduar unë në festival “Një ditë shprese”, një kompozim nga unë vetë? Ajo këngë u hodh në pleh dhe desh zoti që erdhi Papa në Shqipëri dhe më thënë ta këndojo atë këngë. E shikoni se çfarë vlere mori ajo këngë. Por të ishte për këta do të çonin të tjerë, do çonin ata që jepnin lekët. Për festivalin në RTSH nuk bëj asnjë sugjerim, sepse të gjithë ata që vijnë aty, vijnë me një megalomani të madhe, që do të bëjnë diçka dhe nuk bëjnë asgjë.

Folët pak më parë për Ministrinë e Kulturës, e cila ka tashmë gati dhe projektligjin e ri për të drejtën e autorit?

Sa vjet ka që flitet për të drejtën e autorit në vend? Nëse bëhet e drejta e autorit unë nuk shpall vetëvrasje, por jam i lumtur dhe po vdiqa. Jam i lumtur po vdiqa se fëmijët e mi kanë për të pasur diçka. Këtu nuk ke asnjë siguri për të drejtën e autorit. Këndo dhe bëj çfarë të duash, le të jesh dhe artist i madh, shkruaj këngë, poezi, e të tjera, bëj veprimtari, por nuk ka shpresë. Ka vite që diskutohet për ligjin, por asgjë nuk ndryshon në

zbatimin e të drejtës së autorit.

Jeni shprehur dhe për tregun muzikor në vend, sa ka ndryshuar situata kur flitet për probleme?

Asgjë nuk ka ndryshuar, janë po ato. Këtu ka vend për të gjitha, po ta shikoni rrymat hip-hop, arenbi, janë disa rryma që quhen art, pavarësisht se kush i debuton. Në përgjithësi ndiqen nga masa e rinisë, ndërsa në krijimtarinë që mbet më gjatë në Shqipëri që quhet arti i së bukurës, pak vetë e lëvrojnë sot. Ndaj dhe këngët e mia duken pak si o shumë të vjetra, o ufo, që nuk janë pak të kapshme për këtë sistem njerëzish, që pranojnë çdo lloj arti, por jo të bukurën. Unë tani kam në plan dy krijime të reja, që do t’i sjell së shpejti në treg. Janë të tilla, ku njëra është për Rikun dhe tjetra është për këtë nivel që kemi. Njerëzit më thonë, po pse ti kështu? Por u them që dua ta provoj njëherë, që ta mendojnë ata, që jo se nuk di ta bëj këtë që nuk quhet as art, asgjë veçse thjesht fusin vulgaritetin. Do të sjell atë që quhet moderne në Shqipëri, por që për mua nuk është.

Por sipas jush pse është ulur kaq shumë niveli i muzikës?

Është një term, që mund të rrimë shumë gjatë duke e thënë. Dikur ishte censura dhe në muzika ajo është mjet, sepse është dhe në Gjermani, Amerikë, e të tjerë. Në Amerikë dalin në ditë 1 milionë e gjysmë këngë rep, por sa kanë fuqi për të dalë në skenë? Ndoshta një del në skenë. Por tek ne çdo gjë që bëhet në muzikë del në skenë. Ndaj duhet të kemi kritikë në krijimtari. Tek ne edhe një kompozitor i madh që bie në rutinën e këtyre vulgariteteve, thonë i do populli. Tani është e njëjta rutinë dhe shprehje, që e kemi përdorur për 50 vite. Dëgjoni tërë ditën këngë masash, këngë partizane, këngë të ndërtimit socialist dhe thoshin i do populli. Tani akoma mund të rrimë me idenë që i do populli? Por jo, populli do atë që i jep ti.

Pra muzikantët tanë thanë dikur shumë bukur fjalën e vet të censuruar, por muzika rri shumë bukur. Ndaj them që duhet pak censurë, jo ajo lloj censure komuniste, por censurë në art. Arti jonë ka diçka. Unë nuk dua që fëmijët e mi të dëgjojnë në të njëjtën kohë një këngë: *ti nuk po din as me ma lyp*, dhe më pas një këngë tjetër: *o sa të dua se ti je shumë e mirë engjëlli im*. Pra janë në një vulgaritet, një ekstrem ndjenjash.

Janë këngë që shfaqen në një kohë kur dhe fëmijët janë zgjuar, por a duhet censuruar për këtë? Ndodh kjo në Amerikë? Jo. Pra ndaj them, që sot në krijimtarinë muzikore nuk duhet të pranohen vulgaritetet.

Edhe pse i shkëputur prej vitesh nga kinemaja, e keni pasur dhe një angazhim të tillë në film gjatë kësaj kohe?

Kinemaja dikur ka qenë dhe me një lloj komisioni, që bëhet përzgjedhja për rolin e caktuar, ku për një rol vinin 20 veta. Sot të thonë kam një rol të bukur, por nuk do marr para, apo të thonë do më japësh mua kaq para, e të tjerë, janë disa tarifa që bëhen brenda tereses dhe si të bien dakord. Kemi shumë probleme me filmin sot, ndaj dhe filmat tanë dalin pak kërtollë. Nuk mund të jesh në film dhe të bësh të tilla kompromise.

Bashkëbisedoi, Julia Vrap

PLLUMB LULASH VUKSANI, PËRKULEMI ME RESPEKT PËRPARA KUJTIMIT TËND



Ditët e fundit u nda një kjo jetë Pllumb Lulash Vuksani. Pllumbi u lind në fshatin Lekaj të zonës Shalë, 83 vjet më parë. Ai erdhi në jetë në një familje me tipare dhe histori tradicionalisht të që vlenë për tu vlerësuar dhe mbajtur mend gjatë.

Në jetën e tij, Pllumbi, qe një burrë me plotë kuptimin e fjalës, që punoj me ndërmëri e përkushtim për fshatin e tij, për zonën dhe tërë vendin. Ai në gjithnjë jetën e tij punoj me ndërgjegje për të plotësuar detyrat që ju besuan të kryente. Babi i tij, Lulash Mala i Lekajve, qe një burrë i nderuar në fshat dhe të gjithë krahinën, emrin e të cilin e vlerësoj dhe e nderoj edhe Pllumbi. Ai ishte një njeri i mirë, një bashkëshort i mirë, një baba i dashur dhe edukator me shumë vlerë, njeri bashkëpunues dhe tolerant.

Në të gjithë vendet ku punoj, Pllumbi, u shqua si një figurë popullore, e dashur, e respektuar, e ndershme, fjalë ëmbël, i shoqëruashëm më çdo njeri, dhe mbetej dashamirë me njerëzit qoftë edhe me një takim. Pllumbi la një familje shumë të mirë, dy djem dhe tri vajza, la vëllezër e motra të nderuar dhe të respektuar. Veçanërisht la një familje shumë të lidhur me njëri tjetrin, pavarësisht se ku punojnë dhe jetojnë.

Punën, për të ndihmuar familjen, por edhe për të përparuar krahinën, e filloj si mësua dhe punoj në disa fshatra të Dukagjinit. Ishte koha kur punohej fuqishëm për të zhdukur analfabetizmin e rëndë në Dukagjin dhe në të gjithë vendin. Ashtu si edhe shumë të tjerë, edhe Pllumbi u shqua në këtë drejtim dhe u arrit që krahina e Dukagjinit të zinte vendin e parë në shkallë Republike për zionat malore të vendit. Nderë dhe respekt për këtë brez që nuk u kursye kundër kësaj plage të rëndë të kohës.

Do të kujtojmë me shumë respekt, natyrisht, dhe me dhimbje sepse kishim nevojë që të kishim përsëri edhe disa kohë, veçanërisht familjarët e tu, shokët e miqtë, por edhe shumë të njohur ngado që i ke rënë dhe ke punuar. Veçanërisht do të kujtojnë fshati Lekaj, Shala dhe Dukagjini, si një nga bijët e tij më të mirë që gjithmonë edhe personalisht, edhe familjarisht arritën që të ngrenë lartë vlerat më të mira të tyre. Përkulemi me respekt përpara emrit dhe kujtimit tënd, vëllai ynë, miku ynë, shoku ynë, Pllumb Lulash Vuksani.

Martin Çetina, Ndoci Grima, Pjetër Delia, Ndue Zici

HIPOKRIZIA E RADHES

MBRETI VDIQ PO JARA SHKODRANE DO RROJE!

Kënga popullore shkodrane është e vjetër dhe madhështore sa vete Shkodra. Është mushti gjalluer i jetës se këtij qyteti mijëravjeçar. Kënga shkodrane ka një



force tërheqëse mahnitëse, aq sa bukuria rrezedhitës femërore kësaj bacje trendafilore ku këngët e - luleve (vashave)janë jonete me elektrizuese te dashurive te magjishme, te dlira e mekatere qe; shkop-siten tabute e kohërave. Shkodra është një tempull jareve dhe po hyre brenda nuk mund te dalësh, sepse e ndien veten ne një bote te magjishme, te mbushur me dashuri për jetën e njerëzit, midis luleve Ky tempull ka brenda shume apostuj te cilët e mbollën e rriten e ruajtën dhe lartësuan deri ne Olimp këtë kënge qe mbetet një nga perlat me ndritura te muzikës popullore kombëtare shqiptare.

Sot jara shkodrane humbi kryemjeshtrin me shquar te gjitha kohërave.

Jara shkodrane pa emrin e Bik Ndojes do te ishte një vashez e brishte

pa baba. Shkodranë e shkodrane, shqiptare e shqiptare që nga sot e pas Bilbilin gojëmjaltë nuk do ta shihni me kurrë ne skenat tona. Bilbilat në male sot e pushuan këngën kur mësuan se humben krye-bilbilin që këndoj për 80 vjet rresht bacëve te qytetit te tyre. Kënga shkodran sot u vesh ne vello zije dhe loti i kristaltë ju be stalagtit në sy. Kënga shkodrane sot u shëndërrua në marsh funebër për mbretin e saj. Mbreti vdiq por zëri i tij do jehojë sa te jetojnë kënga shkodrane. Kujtimi i Bikut do jetoj sa te jetoj kënga legjende e Rozafës të cilën ai ktheu ne liturgji. Zoti e mori sovarin tone 90 vjeçare dhe i hapi udhën për në amshim. Mbret ynë pushofsh ne paqe

I QAJNË HALLIN PËR SE VDEKURI PËR ATË QE I VOLLËN PËR SE GJALLI!

Sot disa mendje, disa personalitete dhe koleg te sovranit që na la kujtuan se Bik Ndoja ka mbi 25 vite qe jeton me një pension qesharak, ne një pallat te vogël me një biçiklete kineze, madje me ofshamë dikush tha se nuk kishte para as për kafe. Vonë shumë vonë jeni kujtuar edhe ju te çiltër edhe ju hipokrit qe sot patet rastin te bëniti shou. Ku ishit deri sot qe nuk e folët një fjalë për pleqërinë e mjeruar te një fenomeni që u shfaq dhe patëm dhurate të pa zëvendësueshme?! Ju jeni disa nga ata qe jeni turrur dhe ngjitur si rolle pas butes politikes, duke menduar se u be deti kos. Tani qe edhe te verbrit e panë se deti u shterua te mbetur me lugë bosh në brez, u kujtuat te qani për fatin vlerave te përdhosur e nëpërkëmbura nga gangsterizmi politik 25vjeçar. Nuk është Bik Ndoja artisti, shkrimtari, dijetari, intelektual i pare as i fundit që vdes në varfëri. Miliona derra të ngopur (vipa te parasë pushteti dhe seksit), kudo mbare rrozullimit kanë vdekur dhe do vdesim mes luksit dhe askush emrin s’ua ka regjistruar me memorie. As një dite nuk do jetonte me tepër Bika Ndoja sikur te merret enje pension te veçantë te cilin e meritonte si Shënkolli qiriun. Bik Ndojen, Shyqyri Lushin etj kolos si ata i plagosi e i la gjallë politika me mosmirënjohjen dhe idiotësinë e saj. Bik Ndojen, Shyqyri Lushin etj kolos si ata i vramë për se gjalli kur margaritarët e tyre u mbuluan nga ferrat e shëmtuara te tallavasë. “Bilbilesat” shalëzbuluara, gji zjarrta e belzambakta pushtuan skenat, hollete taverenave te natës dhe mitingjet elektorale duke monstrubuar me mikrofon në dore dhe improvizuar me kaseta në xhepi te montuar tek nallbanxhitë muzikës pa kufi. Në këtë xhungël tallavaje të shfrenuar erotike, lulëzoj komercializmi mbi vlerat. Lulëzoi e shëmtuara mbi të bukuren, aktivlera mbi artin. Linden “Mbretërit ri” dhe “Mbretëreshat e reja” që guxuan te sfidojnë ikonat te cilat i përqeshnin dhe i përçmonin.

Këta “Mbretëri” dhe “Mbretëresha te reja” milioner spekulatore të gustove tona primitive nuk mund ta imagjinojnë dot që te këndosh mijëra këngë për 80 vjet rresht dhe të përfundosh me një biçiklete kineze te viteve shtatëdhjetë.

Vetëm te brendshmet e një të ashtuquajture mbretëreshë të kushtojnë disa here me tepër se pensioni që kishte mbreti i vjetër i Jares shkodrane.

Ky është kapitalizmi hibrid me trup njeriu dhe kokë ujku te trëbuar që kemi kultivuar ne çdo fushe te jetës dhe servirim si demokraci te ëndrrave te mëdha humane. Për te mos thënë me te shëmtuarën si tituj në Shqipëri blihen e shiten si kungujt ne treg ka edhe raste kur politika për interesat e veta i lëshon si lopa bajgat. Sa tituj Mjeshtër te Mëdhenj ka marre Shkodra këto 20 vitet e fundit dhe kush i ka marre? Nëse për disa nuk kam as një vërejtje ajo qe them unë dhe gjitha ta që peshojnë me konarin e meritave është se as një Mjeshtër i madh nga të gjallët e sotëm te këngës nuk duhej të guxonte ta kërkonte këtë titull para Bikë Ndojës. Disa u benë Senator pa merita ose para kohe dhe po e gëzojnë në dëlirë. Për dadheveraxhit kemi një urim hipokrit kush është i Zoti mos i shkoftë i zi moti! Por a dëgjohen pikërisht këta hipokrit i qajnë hallin Bikut për se vdekuri për atë qe i vollën për se gjalli!

Prele Milani

Shuhet Kristo Frashëri, profili i historianit të shquar

Akademia e Shkencave njofton se është ndarë nga jeta në moshën 96-vjeçare akademiku Kristo Frashëri. Bën të ditur se Frashëri ndërroi jetë mbrëmjen e 31 janarit, nga një vdekje natyrale. Homazhet për akademikun do të mbahen më 3 shkurt në Akademinë e Shkencave. Shpreh ngushëllimet e saj për familjen Frashëri. “Akademia e Shkencave i shpreh ngushëllimet më të thella fëmijëve, familjarëve e të afërmve për humbjen e këtij personaliteti të shquar të historisë e të mbarë kulturës shqiptare”, thuhet në njoftimin e ASH.

KUSH ISHTE

Kristo Frashëri ishte djali i parë i patriotit dhe rilindasit Anastas Frashëri dhe i Evd-hoksi Tole-Ogrenit dhe rrjedh kështu prej njërës nga dinastitë e familjeve të Frashërit. I pagëzuar në kishën e Shën Triadhës së Fanarit në Stamboll, pati si kumbar Dhimitër Nolin, vëllain e peshkopit Fan Noli.

Prof. Kristo Frashëri ka një prodhimtari shkencore që mbulon një periudhë 70-vjeçare. Që nga viti 1938, kur ka botuar shkrimin e tij modest mbi Jeronim de Radën, ka botuar me dhjetëra e dhjetëra artikuj studimorë, referate historike, vëllime dokumentare dhe monografi shkencore, që trajtojnë pa përjashtim ngjarje, personalitete dhe procese të historisë së Shqipërisë. Ka trajtuar temat nga historia politike, zhvillimi ekonomik, probleme shoqërore, mendimi filozofik dhe lëvizja kulturore shqiptare. Ndër to janë sprovat për të ndriçuar mjegullnajën shqiptare gjatë Mesjetës së hershme, rendin feudal mesjetar në viset shqiptare, formacionet shtetërore mesjetare, shqiptarët në Betejën e Kosovës (1389), figurën e errët të Musa Arvanitasit, tiparet e regjimit feudal turk në Shqipëri, jetën kulturore shqiptare gjatë shekujve të sundimit osman, Rilindjen Kombëtare Shqiptare, Luftën çlirimtare të Vlorës, zhvillimin e ekonomisë së tregut gjatë shekujve XIX-XX, jetën dhe veprimtarinë e Pjetër Bogdanit, Sami Frashërit.



Kështu mund të përmendim veprat e tij më përfaqësuese shkencore të periudhës postkomuniste si “Gjergj Kastrioti Skënderbeu. Jeta dhe vepra (1405-1468) (2002), “Historia dhe përkatësia etnike e himarjotëve” (2004), “Historia e Tiranës” (2005), “Historia e lëvizjes së majtë në Shqipëri dhe e themelimit të PKSH” (2006), “Historia e qytetërimit shqiptar” (2008), “Historia antike e Kosovës, Dardania” (2008), “Monedha, krediti dhe banka në Shqipëri gjatë shekujve” (2011), “Historia e Dibrës” (2012), “Lidhja Shqiptare e Prizrenit” (2012), “Abdyl Frashëri” (2013), “Etnogjeneza e shqiptarëve” (2013), “Sulejman Naibi dhe letërsia shqipe e shek. XVIII” (2013), “Ahmet Zogu, vështrim historik” (2014), “Fillimet e krishterimit në viset shqiptare” (2000), “Historia e Përmetit”, “Frashëri, shkëlqimi dhe rrënimi i tij” (2010), “Mbi historinë e Ballit Kombëtar” (2012), “Identiteti kombëtar shqiptar dhe çështje të tjera” (2006) etj.

Në bilancin e veprimtarisë shkencore të prof. Frashërit të kësaj periudhe përfshihen dhe një varg polemikash për probleme të historisë shqiptare dhe më gjerë,që nuk po i përmendim. Por ajo çka është shumë e rëndësishme të nënvizojmë në punën e madhe që ka zhvilluar ai është rrokja e tërë periudhave të hershme, nga lashtësia, Koha e Skënderbeut, Mesjeta, Rilindja, Shpallja e Pavarësisë, Lufta e Parë Botërore, Lufta e Vlorës, Kryengritja e Qershorit 1924, Regjimi i Zogut, Okupacioni fashist, Lufta antifashiste, Koha e socializmit e deri te Tranzicioni demokratik.

Lista e botimeve të Kristo Frashërit është tepër e gjatë, saqë nuk ka çështje dhe problematikë të historisë kombëtare shekullore dhe aktuale që të mos e ketë trajtuar në botimet e tij. Profesor Emil Lafe thotë për të se “Studimet historike të Kristo Frashërit shquhen për pasurinë e informacionit, për arsyetimin rigoroz, për mbështetjen në dokumente të besueshme dhe për analizën kritike të dokumenteve, për vështrimin kompleks të dukurive historike në ndërlidhjet e tyre të shumanshme dhe me faktorët veprues të brendshëm e të jashtëm, për objektivitetin shkencor të trajtimit dhe qëndrimin parimor në vlerësimin e faktorit shqiptar në historinë e rajonit e më gjerë; ato dallohen gjithashtu për mbrojtjen e vendosur të së vërtetës historike dhe të interesave kombëtarë ndaj shtrembërimeve (të qëllimshme ose jo) të studiuesve të huaj dhe të bëjnë për vete me qartësinë e shtjellimit, me shprehjen dinamike, të rrjedhshme e të pastër.

Përgatiti Lulash Brigja

Shqiptarët e Mesjetës drejtonin botën

Dr. Aleksandre Lambert, historian, drejtor akademik i “School of International Training” në Gjenevë, është autor i disa librave dhe artikujve në fushën e relacioneve ndërkombëtare të filozofisë politike, të politikës së sigurisë dhe lidhjeve civile-ushtarake. Lambert ka vizituar Shqipërinë dhe ka filluar të njohë çështjen shqiptare që në rini të tij me kërkimet e bëra në Arkivin e Lidhjes së Kombeve Gjenevë, kur njohu mirë edhe çështjen çame. Historiani zviceran Dr. Aleksandre Lambert këmbëngul se nuk është e rastit që shqiptarët në asnjë moment të historisë nuk njihen si komb që ka sulmuar kombet e tjerë dhe se shumë shqiptarë kanë shkëlqyer duke drejtuar qoftë perandori, qoftë shtete të tjera. Po kështu, sipas tij, të tjerë shqiptarë kanë lënë emrin e tyre në fusha të ndryshme të shkencave në shtete të ndryshme të botës. Më tej historiani ndalet në zhvillimet pas Luftës së Dytë Botërore, duke shprehur bindjen se ajo që ndodhi me Shqipërinë, me lënien e saj në Bllokun e Lindjes ishte një llogari e bërë nga aleatët që fituan luftën. Në fund edhe disa këshilla se si duhet të veprojnë shqiptarët për t’u ngjitur pranë shumicës, aty ku ata ten-tojnë.

JA Ç’THOTË AI PËR SHQIPTARËT NË KOHËN E MESJETËS:

Në Mesjetë shqiptarët i kanë dhënë udhëheqës botës, udhëheqës laikë ose fetarë dhe personalitete kulturore që i kalojnë kufijtë e Evropës. Disa Papë kanë qenë shqiptarë, për shembull, – Klementi i XI-të më i dalluari prej tyre. Por shqiptarët kanë qenë në krye të feve me rëndësi botërore, si në krye të fesë ortodokse, ashtu edhe të asaj myslimane. Në histori gjejmë udhëheqës të shquar shqiptarë në shumë

vende të Evropës, madje edhe prej atyre që ngandonjëherë kanë përcaktuar fatin e shumë betejave historike (në vitin 1515 që Merkur Bua me kalorësinë e lehtë të Venedikut, e përbërë



e gjithë nga shqiptarë që përcaktoi fitoren e betejës së Marinjanit, që historia e emëroi beteja e gjigandëve dhe jo Françesku i I-rë i Francës, 19 vjeç, që ato dy ditë beteje mësoi se si luftohet). Shqiptarët i kanë dhënë shumë kryeministra dhe gjeneralë të shquar Perandorisë Otomane (vetëm familja Qypri i dha 5 kryeministra Perandorisë). Shqiptarët i kanë dhënë shumë heronj të pavarësisë greke, prej të cilëve po përmend Kundurjotis, Marco Boçari,

Kanaris, Kolokotroni, Karaiskaqis, Bululina. Që ishin në udhëheqje të revolucionit grek, prej të cilëve edhe disa kryeministra të shtetit të ri të pavarur grek. Rumania gjithashtu ka pasur

një familje princore me origjinë shqiptare (Aleksandër dhe Vladimir Gjika si dhe princesha Eleonora e njohur me emrin Dora Distria). Françesko Crispi, shok i Garibaldit, Kavurit e Macinit që ka qenë një kryeministër i madh Italisë, ishte me origjinë shqiptare. Piktorë si Carpaçi, Albani etj., humanisti Leonic

Tome, profesori i Kopernikut dhe shumë personalitete shqiptare, janë nderuar nga historia e Italisë. Muhamet Aliu, reformatori i Egjiptit Modern, që historia franceze e ka quajtur “Napoleon i Lindjes së Afërt” që shqiptari që themeloi dinastinë mbretërore të Egjiptit që mbretëroi gati 150 vjet.

Arkitekti i “Taxhmahallit” në Agra të Indisë, kryevepra e arkitekturës islamike, ishte vepër e një shqiptari ashtu sikurse edhe “Xhamia Blu” e shumë xhami të rëndësishme të Stambollit. Dhe më në fund Heroi Kombëtar i shqiptarëve, Gjergj Kastrioti Skënderbeu, një shembull gati universal i luftëtarit të lirisë, i nderuar në botën mbarë me përm-

endore jo vetëm në Tiranë, Prishtinë e Shkup, po gjithashtu

në Romë, Bruksel, Gjenevë, Detroit, Buenos Aires. Të tjera përmendore për Skënderbeun janë projektuar të ngrihen në Londër, Varshavë, Melbourne, Manila etj. Kur shqiptarët kanë kontribuar kaq shumë për qytetërimin e njerëzimit, përse pak njerëz në botë janë të ndërgjegjshëm për këtë, përkundrazi shumë as nuk kanë dashur ta pranojnë këtë realitet? Duhet thënë se një gjë e tillë shpjegohet edhe nga izolimi relativ jo pa qëllim i shqiptarëve nga komuniteti ndërkombëtar, dhe në mënyrë të veçantë nga ai evropian, që nga Kongresi i Berlinit e këtej (1878).



Në të vërtetë pas mundjes së turqve në luftën ruso-turke, shtypi ndërkombëtar filloi punën për të injoruar shqiptarët duke i ndërruar emrin gadishullit të dikurshëm të Ilirisë të banuar që nga kohët parahistorike dhe deri në ditët e sotme nga ilirianët – shqiptarët. Atë e pagëzuan me emrin e ri që ka edhe sot, Gadishulli i Ballkanit, vetëm duke u nisur nga vargu i maleve Ballkan. Përse iu vërsulën shqiptarëve? Pjesa më e madhe e diplomacisë konservatore evropiane ka përdorur termin pexhoratif “turq” për t’i cilësuar si turq të gjitha komunitetet myslimane në Ballkan, edhe pse shumica prej tyre nuk janë aspak turq. Evropa ka mbështetur dhe ka zmadhuar tokat e Greqisë, të Serbisë dhe të Malit të Zi, në kurriz të shqiptarëve. Asnjëra nga fuqitë e mëdha evropiane nuk e ka mbështetur çështjen shqiptare, kur shqiptarët krijuan Lidhjen e Prizrenit për të mbrojtur çështjen e tyre të drejtë

Dr. Aleksandre Lambert

MARK BREKU NUK MERITONTE NJË VARRIM TË HESHTUR MEDIATIK!

Sapo mora vesh nga miku im Ndue Sanaj, vdekjen e kolegut, tone Mark Bregu, i cili na qenka varrose dhe tashme prehet përjetësisht në amshim. Nuk ka rëndësi se kur vdiq sot dje apo para një jave, rëndësi ka që Mark Bregun nuk do ta kemi më, ne.

Nuk do ta kemi më, në mesin tone një shqiptarë zemër zjarre, shume fisnik, me humor të hollë. Nuk do ta kemi më, në faqet e fletoreve tona, emrin e një publicisti shigjetues nga më të guximshmit. Nuk do ta kemi më, në faqet e fletoreve tona emrin e nje polemisti të shquar, anti-konformistit i lindur, burrë me integritet, që kurre nuk i tha të zezes e bardhe e as anasjelltas, kurre nuk e pershendeti të keqen.

Më parë, se të njihesha me Mark Bregun, si person, jam njohur me shkrimet e tij publicistike, të cilat përshkohen fund e majë nga pathosi nacionalist, nga serioziteti shkencor, nga guximi për të thënë të vërtetën lakuriq, sado e hidhur të jetë ajo. Mark Bregu ishte dashnor shembullor i fjalës së lirë, me të cilën nuk abuzoi asnjëherë. Ai ishte avokat i së vërtetës, të cilën kërkoi ta shkundë nga pluhuri i harresës. Te gjitha periodiket e pas viteve nentëdhjete Veriut si Shkodra, Dukagjini, Shqipëria Etnike, Pishtari, Malesia, Fjala e te tjera, kane mijera fjale zemra te Mark Bregut, pasi ai nuk dinte të shkruante ndryshe, vetem me zemer. Vdekja jote Mark, më pikëlloi dhe e përjetova me dhimbje trishtuese. Ti ishe elegant, elegant në të veshur, elegant në të folur, i hijeshim në të sjellur, plot hire dhe pa vese pleqërie. Nje publicist reshinuar si ju, nuk meritonte nje varrim të heshtur mediatik. Ndoshta nuk jam i mire informuar, por eshte e pandershme që as nje masmedie e ketij qyteti, që e deshe nje jete të tere, me kenge, me humor e me shkrime, nuk foli nje fjale dite e lamtumires tende nga bota e kendejme. Mark Bregu i lehte të qofte dheu i kësaj toke, që pate fe dhe e adhurove si më të shtrejtën perendi.



Prele Milani, publicist

MHILL LOGU - meriton vlerësim dhe respekt

U lind me 29.09.1929 në fshatin Lekaj të zonës Shalë. Shkollën fillore, Mhilli, e ka mbaruar para çlirimit me rezultate të shkëlqyera dhe për këtë është shpërblyer me tre muaj pushime gratis në Itali.

Ka mbaruar një kurs për ekonomist në Tiranë dhe ka filluar punën në atë kohë rrethin e Dukagjinit si ekonomist. Pas një kursi kualifikimi, është emruar mësues në vitin 1955 në Dukagjin, dhe ka punuar në Shosh dhe në Shalë. Në vitin 1958 është mësues në Theth. Gjatë punës prej rreth tri vitesh në arsim është emruar inspektor për arsimin në shkollat e Dukagjinit.

Në vitin 1961 emërohet drejtor i shtëpisë së pushimit të punëtorëve në Theth, detyrë të cilën e ka kryer deri në vitin 1967, pastaj është zgjedhur kryetar i kooperativës Abat-Lekaj. Më pas është larguar nga jeta civile dhe ka kaluar si financier në ushtri. Në këtë sektor ka punuar deri sa ka plotësuar moshën e pensionit.

Ai krijoi familjen e tij në vitin 1957, duke u martuar me Tone Pjetër Prozhmi nga shtëpia e Lul Gjokës në Gjellaj të Thethit. Ata kanë dy djem, Zefin dhe Lapin dhe dy vajza Lucien dhe Liljanën, të katër të martuar dhe me fëmijë. Me kalimin e Mhillit në detyrën e kryetarit të kooperativës Abat-Lekaj, detyra e drejtuesit të shtëpisë së pushimit në Theth i kalon Tones, që qëndroi në këtë detyrë deri në vitin 1974. Pas një pune 45 vjeçare, Mhilli, që nga viti 1990 është në pension, po kështu edhe bashkëshortja e tij, Tonja.

Mhilli me Tonen, bashkëshorten e tij dhe me dy djemtë dhe fëmijët e tyre jetojnë prej shumë vitesh në SHBA, ndërsa vajzat e tyre janë bashkë me familjet e tyre në Shqipëri.

Çifti Logu kalojnë një pleqëri të bukur midis fëmijëve, nipërve dhe mbesave.

Zef, djali i madh, punon në detyrën e shoferit atje ku banon dhe gëzon shumë

respekt nga punëdhënësit. Ndërsa Lapi ka zgjedhur të merret me këngën e muzikën, veçanërisht atë popullore shqiptare dhe shkodrane. Edhe pse larg atdheut, ai



Tone dhe Mhill Logu, 1957

vazhdon ta interpretojë me shumë dashamirësi, por herë pas herët merr pjesë edhe koncertet që organizohen në Shkodër dhe grupet e ndryshme të këngës popullore, por edhe të muzikës së lehte.

Detyrën e bukur të mësuesit, që dikur e pati Mhilli, e trashëgoi vajza e tij, Liljana Luani (Logu) që prej 36 vitesh. Ajo përveçse mësuese e suksesshme punon pa u lodhur me fëmijët qv

janë në nëvojë, veçanërisht ata me probleme vrasjesh dhe gjakmarrjesh, për tu krijuar një jetë më të mirë dhe për ti integruar në jetën shoqërore. Të gjithë këtë punë e bëjnë vullnetarisht. Ka udhëtuar dhe vazhdon të udhëtojë nga fshati në fshat deri në zonat më të thella malore, në ndihmë të këtyre fëmijëve.

Për Mhillin jeta nuk ishte e lehtë, por ai diti ta përballojë me dinjitet, me kurajo dhe me besim.

Bashkëfashatari Martin Çetina kujton: “Me Mhill Logun jemi bashkëfashatar dhe njihemi që kur unë kam qenë fëmijë. Në atë kohë ishte financier pranë organeve lokale të pushtetit. Pas një farë kohë në këtë detyrë kalon mësues në fshatin Lekaj dhe ka vazhduar këtë detyrë deri në vitin vitin 1961 edhe në disa fshatra të tjerë. Vitet e fundit të punës së tij në arsim ka qenë në Theth. Unë kam qenë nxënës i tij së bashku me Vatë Brrakën e disa të tjerë.

Mhill Logu është i biri i Dedë Sokolit, një burrë me shumë vlere në të gjitha drejtimet, dhe Drande Dedës, bija e Dedë Lulashit nga Lotaj, një familje me cilësitë më të mira tradicionale të kohës, bashkëluftëtar i Mehmet Shpendit, Çun Nikës dhe Marash Delisë. Pas disa viteve punë jashtë fshatit Lekaj, Mhilli Kthehet përsëri në fshatin e tij, tash me detyrën e drejtuesit të ekonomisë së përbashkët Abat-Lekaj. Këtë detyrë e mori nga unë, që deri në këtë kohë isha drejtues i ekonomisë së përbashkët vetëm për fashtin Lekaj.

Gjatë gjithë kohës si bashkëfashatar, si mësues, si kuadër drejtues në ekonomi, kemi parë te Mhilli cilësi shumë të mira në punë, marrëdhënie normale shoqërore, familjare dhe kudo. Liljana ka trashëguar profesionin e dikurshëm të babait të saj, mësuesinë. Me plote gojën mund të them se Mhill Logu është burrë dhe familje që meriton vlerësim dhe respekt.”

Luigi Shyti

AROMË KËNGE NË PRISHTINË

Mbresa nga një takim me këngëtares e madhe shqiptare, Nexhmije Pagarusha

Sa herë që udhëtoj për Kosovë për aktivitete të ndryshme kulturore, apo edhe për festa të ndryshme familjare e shoqërore, emocionet për çudi në vend që të bëhen më të zbehta, vijnë e bëhen më të forta, sepse sa herë që unë shkoj atje gjej një mikpritje aq të ngrohtë sa, si i thonë fjalës “me t’fut’ në borxh”. Kjo më ndodhi edhe në udhëtimin e fundit, i cili më frymëzoj që në këtë shkrim të ndalem tek mbresat e pashlyeshme dhe emocionet e paharruara që lidhen me takimin e ngrohtë dhe pritjen aq bujare që më bëri në shtëpinë e saj këngëtarja e madhe shqiptare Nexhmije Pagarusha.

Emocionet më përshkuan trupin kur ajo u shfaq para syve të mi, që në momentin kur u hap ajo derë, që në momentin që dëgjova nga goja e saj përshëndetjen “mirëse erdhët”!

Para meje me një buzëqeshje mirësie, qëndronte një grua e moshuar, e veshur dhe e rregulluar, si për një mbrëmje gala. Ishte këngëtarja e madhe Nexhmije Pagarusha. Me po këtë buzëqeshje, me po këtë mirësi që rrezatonte na ftoi brenda.

Për mua dhe shoqëruet e mia, motrat

këngëtare nga Gjakova, Leonora, Ermina dhe Edmonda Bushi, ishte jo vetëm një moment emocionues, por edhe lumturie. Së bashku me ne ishin edhe këngëtari i shquar kosovar Ismet Peja dhe vëllai i motrave Bushi, kompozitori Anton Bushi. Ajo dhomë ku ne hymë si



mysafirë ishte befasia e dytë. Muret e saj të dekoruara me fotografi ngjanin me një muze të vogël që dëshmon historinë dhe karrierën e saj artistike.

Unë kisha udhëtuar nga Shkodra, pasi kisha

bashkëpunuar më parë me motrat Bushi, por që për mendimin e të gjithëve duhej t’i bëhej e njohur kjo këngë e re vetë këngëtares. Dhe këtë prezantim ajo na e bëri më të lehtë duke na qerasur në mënyrë tradicionale dhe me fjalë të ëmbla që mund t’i shqiptojë vetëm zëri i ëmbël i një këngëtareje.

Ky pra ishte qëllimi i vizitës sonë në shtëpinë e saj, por siç u shpreha edhe më lart takimi u bë kaq emocionues sa që, në momentin kur Pagarusha dëgjoi këngën u përplot dhe na përploti edhe ne, sepse përmbajtja e këngës, kompozimi dhe interpretimi i revokuan asaj kohët e suksesshme në skenë, kur këndonte edhe këngën simbol “Zambaku i Prizrenit”.

Një takim kaq i ngrohtë për ne, për mua si autor i tekstit dhe realizuesit e këngës, ishte si të thuash “leja”, “miratimi” që Nexhmije Pagarusha i bëri këngës.

Qëndrimi në shtëpinë e saj u bë edhe më i këndshëm, jo vetëm nga bisedat për të tashmen dhe të shkuarën, por sidomos kur kjo zonjë e nderuar, artiste e madhe na recitoi fragmente poezish dhe na këndoi pjesë nga

këngët më të njohura të repertorit të saj, duke përdorur ndoshta “një teknologji” të vjetruar, nostalgjike për te, një magnetofon që e përdorte me aq siguri dhe pasion.

I bëmë një propozim, të cilin pas një hezitimi e pranoi, duke na dhënë kështu një kënaqësi të madhe, kur u tregua e gatshme të merete pjesë në realizimin e videoklipit, duke u bërë personazh i tij dhe duke sfiduar moshën e saj. Në sjelljet e saj, në sytë e saj buronte dashuria e madhe për këngën, pasioni i pashtershëm për artin, por edhe figura e dashur e një mësueseje që ngazëllehete kur i mbushet zemra me kënaqësinë e madhe për brezat që do të jenë vazhdimësia e veprës së saj.

Ajo na falenderoi të gjithëve, duke e quajtur këtë ditë si një ditë pranvere, si një ditë që i solli lumturi, që e rinoi, por që edhe i freskoi kujtimet që siç tha edhe vetë, nganjëherë flejnë bashkë me mua e presin dikë, si puna juaj që të zgjohen.

E hodha këtë shkrim në letër jo si një informacion, por ashtu siç jam shprehur më lart, si mbresa dhe emocione të pashlyeshme, vlerat e të cilave i shtuan akoma më tepër promovimi dhe shfaqja me sukses në ekran e këngës “Zambak i bardh” asht kanga jote” përmes një videoklipi të realizuar me pasion e dashuri nga Anton Bushi.

U ndamë atë ditë nga kjo dive e madhe e këngës shqiptare duke i uruar jetë të gjatë e pleqëri të bardhë si zambakët e Prizrenit.

Ramazan Çeka, Janar 2016

Milan Shuflai, një zemër kroate që rrahu për Shqipërinë

Zylyftar Hoxha

Vepra dhe kontributi i albanologut të shquar kroat Milan Shuflai njihet mirë nga rrethet shkencore, letrare dhe historike shqiptare. Para disa vjetësh, ish-Presidenti i Republikës Alfred Moisiu, duke shfrytëzuar sesionin shkencor “Shuflai dhe Shqiptarët” të organizuar nga Akademia Shqiptare e Shkencave në Tiranë, e dekoroi Shuflajn pas vdekjes me Urdhrin “Naim Frashëri i Artë”, me motivacionin “Për kontribut të shquar në studimet albanologjike, për karakterin shkencor dhe objektiv të mbrojtjes së çështjes shqiptare në veprën e tij”. Ambasada shqiptare në Zagreb ka vendosur themelimin e Certifikatës së Meritës “Milan Shuflaj”, për të nderuar personalitete, institucione apo organizata që japin kontribut të spikatur për forcimin e miqësisë dhe marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve dhe popujve tanë, shqiptar dhe kroat.

Deri këtu, mirë. Por është për të ardhur keq, se, si edhe për raste të tjerë, edhe në rastin e njohjes dhe vlerësimit të shkencëtarit dhe albanologut Shuflai, bëhet shumë pak: nuk ka një shenjë, një bust, një emër të dukshëm të tij në një nga institucionet tona kulturore dhe shkencore për të cilat ai dha dhe jetën.

Milan Shuflaj, martir i albanologjisë

Megjithëse, siç thamë më sipër, ai njihet në mjedise të caktuara, përsëri ne po “e sjellim” edhe një herë albanologun e shquar për një lexues më të gjerë në faqet e gazetës “DITA”, në suplementin “Memo-Enciklopedik: të së dielës për ta njohur e vlerësuar më mirë këtë figurë të ndritur, këtë martir të shkencave historike dhe albanologjike.

Milan Shuflaj lindi në Lepogllav të Krocisë më 9 nëntor 1879. Pasi mbaroi shkëlqyeshëm gjimnazin, vazhdoi studimet për shkencat historike në Universitetin e Zagrebit. Qysh në Universitet lexonte në origjinal veprat historike të shkruara në greqishten e vjetër, në latinisht, italisht, spanjisht, gjermanisht, anglisht, frëngjisht apo hungarisht. Ai njihnte në themel të gjitha gjuhët sllave e me vonë mësoi hebraisht, shqip e sanskritisht. 24 vjeç, afirmohet si studiues i përmasave evropiane.

Pas studimeve universitare bashkëpunoi me Shmiciklasin për hartimin e korpusit “Codex diplomaticus”. Gjatë vitit 1902-1903 punoi pranë Institutit të Studimeve Historike në Vjenë ku boton “Dokumente private të Dalmacisë”. Nga viti 1904-1908 punoi në muzeun popullor të Budapestit. Vepra monumentale e Shuflajt mbetet “Acta et diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia” që do të thotë “Dëshmi dhe dokumente që ilustrjnë ngjarjet e Shqipërisë në kohën mesjetare”. Shkurt, kjo vepër me dy vëllime për historinë e Shqipërisë njihet me emrin “Acta Albaniae”. Volumi i parë u botua në Vjenë me 1913, kurse volumi i dytë më 1918 po në Vjenë. Ato flasin për Shqipërinë e viteve 334-1406 dhe janë shkruar në bashkëpunim me studiuesit K.Jirecek e L.Talocin.

Në vitin 1916 e më pas boton: “Gjendja kishtarë në Shqipëri”, “Kufijtë e Shqipërisë në mesjetë”, “Shqipëria mesjetare”, “Lidhja hungaro-shqiptare në Mesjetë”, “Fatet politike të temës së Durrësit”, “Biologjia e fiseve të popullit shqiptar”, etj. Pas Luftës së Dytë

Botërore, me krijimin e shtetit sllav, ku veç Serbisë përfshihet edhe Sllovenia e Kroacia, për historianin, që tani ishte bërë i dallueshëm, fillojnë ndjekjet dhe persekutimet. Arrestohet, burgoset dhe dënohet me 3 vjet e gjysmë burg si anëtar i Komitetit Kroat të formuar në Grac të Austrisë. Serbët nuk mund të harronin aq kollaj argumentet dhe analizat që ai kishte bërë për lashtësinë e shqiptarëve.

Pasi del nga burgu i Mitrovicës boton “Mjegullat kombëtare”, “Kadastrat e Shkodrës”, “Ciklonet etnike në Ballkan”, “Kështjellat dhe qytetet mesjetare të Shqipërisë”, “Serbët dhe shqiptarët”, “Mozaiku nacional në Maqedoni”, “Qytetet dhe fshatrat në mesjetë” etj. etj, gati 3 mijë tituj librash e artikujsh studimorë mbi Shqipërinë, Serbinë, Kroacinë, Bullgarinë, Rumaninë, Hungarinë, Malin e Zi, Italinë, Slloveninë, Austrinë.

Milan Shuflaj ka botuar edhe me pseudonimin Alba Limi. Me këtë emër ai ka botuar romanin historik “Konstandin Balshaj”.

Shuflaji është një nga personalitetet më të mëdhenj të shkencës dhe albanologjisë, një nga përfaqësuesit më dinjitoz të saj. Nuk ka albanolog tjetër që mund t’i dalë përpara Shuflait për periudhën e Mesjetës. Me dokumente dhe fakte ai argumenton fillimet e para të jetës qytetare të Shqipërisë, shumë kohë para se sa të vinin sllavët. Ai argumentoi prejardhjen tonë. Në qoftë se ka një përcaktim të saktë historik për kohën ilire, helene, romake e bizantine të Shqipërisë, ai është Milan Shuflai. Të gjithë ata që duan të flasin për historinë e Shqipërisë, nuk duhet të injorojnë ose anashkalojnë Shuflajn.

Sipas disa të dhënave më të reja të zbuluara në Arkivin Shtetëror Kroat në Zagreb, dr. Milan Shuflaj ishte njëri ndër shkencëtarët e rrallë në botë që u përcoll hap pas hapi nga policia, e madje jo vetëm ai, por edhe personat me të cilët kontaktonte, duke përfshirë këtu edhe anëtarët e familjes së tij të ngushtë dhe të gjerë. Një mbikëqyrje e tillë kishte filluar në fund të vitit 1922, gjë që mund të dëshmohej nga dokumentet arkivore. Fillimisht vëzhgohej vetëm ditën, ndërsa më vonë 24 orë pa ndërprerje. Për çdo të re nga mbikëqyrja i raportohej drejtpërdrejt kryeministrit Petar Zhivković, e më vonë pasardhësit të tij Milorad Srshkiçi në Beograd dhe vetë Mbretit, në mënyrë që të kishin parasysh veprimtarinë dhe lëvizjet e shkencëtarit të madh.

Vritet pabesisht në Zagreb, me 18 shkurt 1931, një muaj pasi kishte vizituar Shqipërinë.

Letërkëmbimi Milan Shuflaj dhe Mit’hat Frashëri, çfarë i shkruajnë njëri-tjetrit

Në përgjithësi epistolari i Milan Shuflajt është i varfër, sepse ashtu siç është thënë diku në këtë shkrim, atij iu shkatërrua gjithçka nga policia kur u vra. Megjithatë, ato që kanë mbetur janë letërkëmbime me personalitete të kohës si me dijetarë dhe personalitete të njohur të arsimit dhe të kulturës botërore si Jirecek, Taloc, Jovan Radoniqin; drejtorin e Institutit të Evropës Lindore, Amadeo Khanini; ministrin e Arsimit të Shqipërisë, Adburrahman Dibën; ministrin e Arsimit të Hungarisë e më së shumti me

Mit’hat Frashërin (Lumo Skëndon) në Shqipëri.

Në këtë rast do të veçonim letërkëmbimet në Shqipëri, veçanërisht ato me Mit’hat Frashërin. Letrat janë shkruar latinisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht, hungarisht dhe kroatisht. Objekti i tyre është puna



këmbëngulëse e Shuflajt në hulumtimin, vjeljen dhe sistemimin e korpusit të madh të burimeve relevante për të rrumbullakuar botimin e “Acte Albaniae” si dhe përballja me pengesat e mëdha të qëndrimit në Shqipëri dhe të hulumtimeve në Itali.

Me interes është letërkëmbimi me Lumo Skëndon, bibliofilin tonë të rrallë që ndiqte me lakmi botimet e autorëve të huaj për historinë dhe kulturën shqiptare. Në librarinë e tij të njohur mund të gjeje titujt e rinj në gjuhë të ndryshme, pa harruar ato të Shuflajt, me të cilin po për këtë shkak ai kish lidhur miqësi.

Në letërrën e tij të parë të 30 qershorit 1929 ai donte të mësonte nga albanologu i njohur se a do të vazhdonte nxjerrjen e “Acte Albaniae” dhe sa vëllime do të ngërthente ky botim. Shuflaj iu përgjigj menjëherë duke shkoqitur në pika të përgjithshme projektin e 4 vëllimeve vijuese të “Acte Albaniae”, që do të përfshinin burimet e vjela në arkivat e Venecias, Vatikanit dhe Dubrovnikut dhe do të zinin fill në vitin 1451 të pushtimit aragono-napolitan të Krujës dhe do të shtriheshin deri në vitin 1571. Në vëllimin 3 do të botohej “in extenso” dhe Kadastrat i njohur dhe shumë voluminoz i Shkodrës i vitit 1416 së bashku me kopjet e dokumenteve nga arkivi i Barcelonës dhe Milanos që hedhin dritë mbi marrëdhëniet e Skënderbeut me sultan Muhametin II, të cilat Shuflaj ia kishte huazuar Radoniqit, por që nuk i pa kurrë me sy.

Mit’hat Frashëri ia kishte bërë të njohur projektin e Shuflajt jo vetëm ministrit të Arsimit, Dibra, por edhe vetë mbretit Zog. Është kjo arsyeja që ministri i Arsimit e mirëpriti projektin kapital të albanologut dhe ballkanologut të njohur. Ai e përgëzonte shkencëtarin për kontributin e madh shkencor, e falënderonte për punën shumë të veshme rreth hulumtimit të mëtejshëm të dokumenteve arkivore të historisë shqiptare mesjetare dhe e bënte me dije se qeveria e tij mbretërore i kishte akorduar 75.000 franga ari për vjeljen e dokumenteve arkivore dhe botimin e tyre me katër vëllime. Përballimi i shpenzimeve në një shumë kaq të madhe nuk ishte sakrificë e vogël finan-

ciare, kur dihet se në ç’shallë të zhvillimit ekonomik ishte Shqipëria.

Në një letër që Shuflaj i dërgonte drejtorit të Institutit të Evropës Lindore, Xaninit, i shpreh gëzim për marrjen e pasaportës për në Shqipëri, që kishte dy vjet që e kërkonte. Në atë letër ai i lutej mikut të tij t’i përvishej punës dhe të zgjidhte kopjesit e dokumenteve në Romë, Venecia, Napoli dhe Ankonë, duke e siguruar atë se qeveria shqiptare do t’i hiqte të gjitha shpenzimet. Shuflaj mbështetej në shkresën e ministrit Abdurrahman Dibra me të cilën njoftohej për dërgimin e 3000 franga ari në bankën zvicerane si paradhënie. Ai i tregon mikut të tij se si më 16 janar ministri Dibra shtroi darkë për nder të tij në hotel “Tirana” dhe se si ai kishte jetuar çaste ngazëlluese që dollia për shëndetin e tij të ngrihet në gjuhën italiane.

Shkaku i vdekjes së Shuflait, vizita në Shqipëri

Mbreti Zog ishte mirinformuar mbi veprimtarinë e Milan Shuflait për Shqipërinë. Atij i kishin folur për kontributin e madh që ai kishte dhënë në historinë e Ballkanit dhe veçanërisht të shqiptarëve si populli më autokton dhe më i ngulur në këtë rajon, ndaj dhe me kënaqësi e ftoi në Shqipëri, në oborrin e tij.

Shuflai erdhi në Tiranë në janar të vitit 1931 dhe qëndroi 8 ditë. Veprimtaria më interesante në këto ditë ishte fjala e tij në parlamentin e asaj kohe. Ishte interesante, jo vetëm se ai foli shqip dhe për këtë u duartrokit disa herë, por edhe se dha argumente bindëse për prejardhjen e shqiptarëve, si dhe për punën që duhet të bëhej në të ardhmen për ta evokuar këtë prejardhje.

Ai u largua nga Shqipëria i impresionuar, i gjallëruar dhe i rinuar, i ushqyer me vullnetin e çeliktë për hulumtime të mëtejshme në përmbyllje të veprës së tij kapitale që do të pasuronte dhe thellonte studimet albanologjike dhe ballkanologjike, flamuri shqiptar ishte për atë dhuntia më e çmueshme që mori me vete.

Në Zagreb, pas kthimit nga Shqipëria, atij i vjen një letër kërcënuese për të hequr dorë nga studimet dhe dëshmitë historike. Pas këtij kërcënimi ai nuk e dha veten. I nxitur nga vizita në Tiranë, ai vazhdonte të punonte për pjesën e tretë të “Acta Albaniae”. Por nuk kaloi muaji dhe në mbrëmjen e 18 shkurtit 1931, ndërsa kthehej në shtëpi, tre vetë e qëllojnë me mjete të forta në kokë. Vdes po atë natë në moshën 52-vjeçare, pa mundur të flasë.

Vdekja u mundua të mbulohej, por Shuflaj ishte një autoritet shkencor dhe lajmi u përhap në tërë botën. Jehona e saj ishte e madhe. Reaguan me shkrimet e tyre “Tribuna” Romë, “Berliner Tagblatt”, “New York Times”, “Frankfurter Zeitung”, “Arbënia” Tiranë, “Vullneti i Popullit” Tiranë etj. Me një memorandum të veçantë reaguan edhe kolosët e shkencës e të letrave, si Albert Einstein, Heinrich Mann, dr. Josef Bajza, dr. Max Hildebert Boehm, dr. Karl Fritzler, dr. Zenon Kuziela, dr. Martin Spahn, dr. Branimir Jeliq, Josip Milković, Lumo Skëndo, Faik Konica, si dhe Ligue Internationale des Droits des L’Homme, Federation Universitaire Internationale.

Më vonë doli se vrasjen e kishte planifikuar dhe organizuar që më



datën 15 shkurt policia e Zagrebit. Arsyeya? E thjeshtë. Ai ishte kundër teorive të serbëve që e quanin popullin serb popull misionar, një popull i cili qëndron mbi të tjerët. Ishte kundër asaj që propagandohej se sllavet e jugut kishin ardhur në këtë rajon të Evropës për të emancipuar barinjtë e egër të Ballkanit. Kjo filozofi që ekziston dhe sot e kësaj dite binte ndesh me frymën evropiane të Shuflajt. Ja, pra, pse u desh vdekja e shkencëtarit të madh.

Ky fisnik me zemër të madhe do të shkruante për Shqipërinë ashtu siç e shihte realitetin, në dritën e fakteve historike. Milan Shuflaj ka vendosur një gur të rëndë themeli në murin historik ku shkruhet se shqiptarët janë autoktonë në territorin e tyre.

Me vdekjen e Shuflajt, albanologjia humbi njërin nga mbështetësit kryesorë që kishte në atë kohë, studimet e të cilit edhe sot e kësaj dite janë me vlera të larta dhe pothuajse të pazëvendësueshme.

“Acta Albaniae”, një vepër e pambaruar
Vepër e Shuflajt gjendet në arkivin e Vjenës, në Arkivin tonë të Shtetit dhe në atë të Kroacisë. Por te ky i fundit jo i plotë, pasi fill pas vrasjes, në shtëpinë e tij policia bëri bastisjen e rrufeshme, përmbysi dhe zhduku pjesën më të vlefshme të materialeve që gjeti, shumica me vlera unike. Në këtë rast humbi edhe vëllimi i tretë i veprës monumentale “Acta Albaniae” të përgatitur për shtyp. Të paktën kështu është thënë deri vonë, derisa para pak vjetësh, derisa në Arkivin Qendror të Shtetit u gjet një dosje e veçantë me 50 faqe material dhe me një pasqyrë lënde me tituj për Historinë e Shqipërisë nga viti 1400-1536, pjesë tjetër lënde ndodhet në arkivin kroat, një pjesë tjetër në Venedik, Vatikan, Napoli, Raguzë, Vjenë etj. Ngelet detyrë që këto pjesë të grumbullohen, të konceptohen dhe redaktohen në një vepër të plotë nga një grup autorësh kompetentë siç e kishte ëndërruar autori.

Shuflaj, mbi qytetet dhe kështjellat shqiptare

Milan Shuflaj, studiues dhe albanolog i madh kroat, njohës i mirë i historisë mesjetare shqiptare shquhet për kontributin e madh që dha në ndriçimin dhe trajtimin e problemeve të ndryshme në fushën e historisë mesjetare shqiptare. Në këtë pikëpamje ai shquhet edhe si njohës i mirë i qyteteve të Shqipërisë në përgjithësi duke filluar që nga lindja dhe zhvillimi i tyre për të vazhduar gjatë gjithë mesjetës. Në veprën e tij “Qytetet dhe kështjellat e Shqipërisë kryesisht në mesjetë” që për herë të parë u botua në vitin 1924 në Vjenë në gjuhën gjermane dhe që është përkthyer dhe botuar në shqip nga shtëpia botuese Onufri, trajtohen pothuajse të gjitha aspektet shoqërore, juridike, ekonomike që i karakterizuan qytetet e Shqipërisë kryesisht në mesjetë. Sipas Milan Shuflajt qytetet që gjenden në bregun lindor të Adriatikut ekzistojnë prej mijëra vjetësh. Shkodra gjendet pranë kështjellës, Lezha në grykën e Drinit, ndërsa Durrësi cilësohet si qytet ndërkombëtar detarësh dhe tregtarësh. Në lindje të Vlorës gjenden dy qytete të mëdha Bylisi dhe Amantia. Ndërsa rreth dhjetë stade larg nga Vjosa gjendej Apolonia, e cila ka qenë një qendër e rëndësishme e qytetërimit urban.

NJË TUBË FJALË ZEMRE, -në përvjetorin e lindjes-

Vitet ecin, ikin,
Koha nuk ndalet,
Por ti qëndron përherë,
Si bleta mbi petalet.

Bashkë, ne ecëm,
Hapin se ndalëm,
Nga viti në vit,
dalëngadalë u rritëm.

Këtë datëlindje jemi larg,
Distanca ka pamundësinë,
Por koha as largësia,
S’e vyshkin dashurinë.

Kalëruam bashkë,
Shumë vite janë bërë,
Jo pa vështirësi,
Por me dashuri e mall.

Eh, si ikin vitet,
Shpresojmë edhe të tjera,
Sot na gëzojnë fëmijët,
Dhe nipa e mbesa.

Vitet rrjedhin,
Si ujërat në male,
Koha vepron fuqishëm,
Në ballë formon kanale.

Thinjat, na fisnikërojnë,
Ka ardhur pleqëria,
Ajo mund të vonohet,
Atë e pengon dashuria.

Fytyrës i takojnë
Puthja, gëzimi, a loti,
Por atë tënden,
Vështirësia se lodhi.

Vitet rrjedhin një e nga një,
Siç rrjedhin lumenjtë,
Dashuria na mbetet,
Përherë e freskët.

Ka vetëm lindje dashuria,
Ajo është gjithçka,
Po të vdesë ajo,
Më njerzim nuk ka.

Këtë tubë fjalë zemre,
Dashuria ime, po të dërgoj,
Me madh e dashuri,
Të puth, të përqafoj.

Edhe pse larg,
Me zemër, si dikur,
Të marr në krahë,
E kokën mbështet unë.

Luigj Shyti
12.2.2016



DASHTNIA E NANËS

Legjenda thotë: “Vajza i tha djalit,
Që t’më bindësh për dashtninë,
Më sill zemrën e nanës,
Ta shoh me sytë e mijë.

Djali te nana vrapoi,
Zemrën ja shkuli nga gjokësi,
Dhe me shpejt u kthye,
Për te e dashtuna vrapoi.

Rrugës tek po kthehej,
Rreshqet, bie për tokë,
Ai thirri: “Oooh nano”
Zemra e nanës që mbante në dorë,
I përgjigjet “A u vrave biro.”

Eh, Nana,
Bekon, asnjëherë nuk mallkon,
Nuk merr hak, nuk mban mëni,
Ajo falë dashuni,
Nuk asht mizore,
Asht zemër gjanë,
Ajo është hyjnore,
Prandaj quhet nanë.

O Nanë,
Pa ty s’ka dashtni,
Pa ty s’ka jetë,
Pa ty s’ka lumturi.

O Nanë,
Ti je mirësia,
Ti je e vërteta,
Ti je dashunia,
Ti je vetë jeta.

Ndue Mici
23.2.2016

NDALO BEG, SE KA HENDEK

Ke zhvillue shumë përlëshje
Të vjen dore për gjithçka
Me mjeshtri përdor çdo veshje
Me fitue vetëm para.

Duert t’u ngjiten nëpër xhepa
Kapsin e grabsin i do shumë
Të ka dalë barku, je frye mbrapa
Sepse të mirat i ke lum.

Vishesh king me jakë të bardhë
Bardhë e kuq fytyra të shkelqen



Verdhushka vijnë me radhë
Në valixhe kanë zan vend.

Por një ditë diçka ndodhi
Më vjen keq që ta përmend
Shumë telashe paraja të solli
Mendt e kres s’ti la në vend.

Erdh një za dhe një kërkesë:
Ndalo beg se ka hendek
Dhe mandej pa vonesë
Ta zun rrugën në një shteg.

Ishte dora e drejtësisë
Që të zbriti ty nga fiku
Sepse djersa e njerëzisë
I zë frymën çdo të ligu.

DËGJO MIRË OR TI ZOTNI

Ish i fisit burr i botës
Ndër të gjithë dukej më i miri
Një ditë mori fuqinë e votës
Dhe u bë kryetar i këshillit.

Menjëherë iu rritë mendja
Harroj njerëzit dhe kutinë
E ngatroj shumë keq gota
Kur pranë saj kishte rakinë.

Bashkë me mezet një nga një
E ka shtrur në orarin zyrtar
Kurse ne po presim në shi
Një përgjigje për me marë.

Ka disa ditë që nuk firmos
Sepse do një diçka tjetër
Nga mendt e kresë është flamos
Ky përbindësh pa shpirt e sedër.

Dëgjo mirë or ti zotëri
Që po lot me të drejtën tonë
Në këtë “zyrë” prap do vij
Por për ty ka me qenë vonë.

Shiko gishtin tim përpjetë
Që me ‘të bëhet çdo punë
Në rast nevojë e fus në b....!
Por për ty nuk e çoj unë.

Luigj Temali

REDAKSIA

Kryeredaktor: Luigj Shyti

Redaktorë: Lazër Stani, Roza Pjetri, Prelë Milani, Lazër Kodra,
Suela Ndoja, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja

Mundësoi Botimin:

AV. ANTON KOSTERI

Kryetar i degës së Shoqatës Atdhetare
Dukagjini, Shkodër

